9. Blerja dhe shpërndarja e lloptopëve për të gjitha klasat dhe të gjitha shkollat.
10. Blerja dhe furnizimi i të gjitha shkollave me rekuizita sportive dhe mjete tjera didaktike të sportit.
11. Planifikimi dhe sigurimi i transportit për nxënësit që udhëtojnë më larg se 3 km.
12. Vijim i rregullt i nxënësve në shkollë.
13. Sigurimi i lëndëve djegëse për nevojat e IA. Sigurimi i ngrohjes për dimër i IA.
14. Funksionalizimi i platformës digjitale për menaxhimin e sistemit arsimor në komunë.

15. Subvencionimi i nxënësve dhe mësimeve të suksesshëm.
16. Sporti Shkollor-Garat komunale ne Ping-pong.
17. Java e Kodimit.
18. Kuiz i diturisë me të gjitha klasët e V-ta të SHFMU.
19. Paisja e shkollave me teknologji që mundëson pjesëmarrjen në gara të robotikës.
20. Renovim i plotë i SHFMU "Skënderbeu" Hogosht.
21. Renovim i plotë i SHFMU "Metush Krasniqi" Roganë.
22. Renovimi i IP "Filizat" në Kamenicë.
23. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve.
24. Instalimi i teknologjisë që për evidentimin e vijueshmërisë në shkollat e mesme
25. Kontraktimin e materialeve video-ilustrative për të gjitha lëndët mësimore dhe të gjithë nxënësit në SHF
26. Aktivitete të shumta për nder të 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme:

Raporti i Gjendjes Civile (OFIQARIA)

	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	TM3	Tetor	Nentor
Dokumentet e lëshuara 01.06.2023-30.11.2023							
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile	940	1427	1406	967	3800	744	906
Certifikatë lindje	706	547	1329	553	2429	408	355
Certifikatë martese	230	287	669	432	1388	211	153
Certifikatë vdekje	106	107	237	135	479	145	165
Aktvdekje	5	17	34	14	65	5	30
Certifikatë vendbanimi	90	91	123	127	341	243	77
Certifikatë të bashkësisë familjare	350	396	345	260	1001	263	192

Certifikatë të gjendje martesore	51	74	98	69	241	37	43
Certifikatë shtetësie	9	4	15	27	46	5	7
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi	30	13	28	41	82	23	27
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës	4	9	10	7	26	4	4
Konfirmime / Vërtetime	9	7	13	9	29	3	6
Pranim Atësie	2	1	1	0	2	1	0
Deklarata për kthim te mbiemrit brenda 6 muajve	2	2	1	0	3	0	1
Procedura mbi 18 vjet regjistrim	2	7	10	8	25	5	7
Persona mbi 90 vjet	6	4	4	4	12	4	2
Përgjigje Gjykatave	1	3	5	1	9	1	4
Përgjigje divizionit te Pensioneve	1	8	1	0	9	2	1
Aplikim për fitim të shtetësisë	5	2	11	5	18	0	2
Aplikim për lirim të shtetësisë	4	0	1	0	1	0	1
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile dhe shërbim:	2512	3212	4250	2613	6863	2104	1925
Totali	2553	8809	3212	2661	10213	2014	1980
Dokumentet e leshuara 01.01.2023-31.05. 2023							
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda vendit :	16	0	0	0	16	0	0
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, jashtë vendit :	17	59	55	14	128	13	10
1 Martesat e lidhura dhe rishkrim martesë:	1	12	20	18	50	0	15
Shkurorëzimet :	1	3	5	2	10	2	2
Martesat me element të huaj :	5	5	9	3	17	0	4
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda vendit :	3	10	8	7	25	1	3
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit:	4	3	3	1	7	0	1
Mjete jetese	1	7	35	5	47	4	4

Vendime për korrigjime në emra personal :	0	0	1	2	3	0	0
Vendime për ndërrime në emra personal :	48	13	1	0	14	0	2
Totali:	96	112	137	52	301	20	42

Drejitoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi:

Punët e realizuara në fushën e trashëgimisë:

50011 Trashëgimitë								
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Ndarje Bashkim parcelash	15	21	11	14	20	18	99
02	Regjistrimi i ndërtesave	00	00	01	01	01	02	05
03	Ndarja Bashkimi e ndërtesave	00	00	00	00	00	04	04
04	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00	00
05	Ndarja e pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00	00

06	Bashkimi i pjesëve të ndërtesave	00	00	00	00	00	00	00
07	Regjistrimi Çregjistrimi hipotekave	04	01	02	01	02	01	11
08	Regjistrimi i shitblerjeve	08	29	26	31	21	11	126
09	Regjistrimi i trashëgimive	07	22	11	26	14	08	88
10	-/-/- dhurim të pronës së paluajtshme	10	33	41	42	40	19	185
11	-/-/-i ndërrimit të pronës së paluajtshme	00	00	00	00	00	00	00
12	-/-/- i shkëputjes së bashkësisë familjare	00	00	00	00	00	00	00
13	-/- i përkujdesjes së përhjetshme(Gjykat)	00	02	02	02	01	00	07
14	-/-/- i pronave të eksproprijuar	00	00	00	00	00	00	00
15	Regjistrim Çregjistrimi servitutit	00	00	00	00	00	00	00

16	Regjistrimi Çregjistrimi i tatim. në pronë	00	00	00	00	00	00	00
17	Fleta poseduese	287	314	176	366	200	61	1404
18	Kopje plani	37	39	40	38	60	17	231
19	Vërtetim qe nuk posedon pasuri	04	02	04	07	05	04	26
20	Kërkesë për historiat	00	00	00	00	00	00	00
21	Vërtetim për social	03	00	06	01	00	01	11
22	Regjistrimi Çregjistrimi i barrës tatimore	00	00	00	00	00	00	00
23	Regjistrimi Çregjistrimi i ngarkesave tj.	00	00	00	00	00	00	00
24	Regjistri. Çregjistr.i i qira mbajtjeve(3v)	00	01	00	00	00	00	01
25	Lënde te skanuara	43	85	85	156	132	50	551

26	Lënde për shpallje publike	37	79	79	106	113	37	451
27	Njoftim palët	93	90	154	86	93	66	582
28	Regjisë i ndërtesës –pjesë se ndërtesës	00	00	00	00	00	00	00
29	Regjistrimi i korrigjimeve në regjistër	00	02	01	00	00	00	03
30	Regjistrimi i rregullimit të kufiri	01	01	03	05	00	00	10
31	Regjistrimi i ndërrimit të shfrytëzimit akt	00	00	00	00	00	00	00
32	Regjistrimi i vërtetimit identiteti	00	10	07	19	12	00	48
33	Regjistrim i shfrytëzimit aktual	00	00	00	00	00	00	00
34	Te bartura nga muaji paraprak	25	33	46	55	44	31	234
35	Shkesa për zyrën e kryetarit	04	01	04	04	02	01	16
36	Shkresa për drejtorit	05	02	02	01	01	01	12

37	Për zyrën e gjendjes civile	11	14	06	12	10	03	56
38	Për Noter	02	01	01	02	00	00	06
39	Për përmbaues	00	00	00	02	00	02	04
40	Për AKK	00	00	02	00	00	00	02
41	Agjencinë Antikorrupsion	00	00	00	00	00	00	00
42	Për Avokat	00	00	02	01	01	00	04
43	Përgjigjeje palëve	97	172	154	86	93	88	690
44	Ndarje fizike	00	00	00	00	00	02	02
45	Te Ndryshme	01	00	01	03	01	02	09
46	Lënde te pranuar dhe te regjistruara	53	53	54	100	100	25	385
Total		747	1007	921	1167	966	454	5263

Tabela Nr. 2. Punët e realizuara në fushën e matjeve:

50504 Matjet

Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Azhurnim	13	17	10	15	19	11	85
02	Matje	00	00	00	00	00	00	00
03	Parcelim	03	05	06	09	00	02	25
04	Bashkim parcelash	03	05	06	05	05	02	26
05	Kopje plani	37	39	40	38	00	17	171
06	Matje ndërtesash	00	00	00	00	00	00	00
07	Caktim kufijsh (Vektor Parcelave)	00	19	05	09	05	04	42
08	Koordinata	12	10	10	04	10	04	50
09	Identifikim	00	00	00	00	00	00	00
10	Ndarje	02	00	00	00	00	00	02

11	Rregullim kufijsh	01	01	00	00	00	00	02
12	Të tjera-Aplikacione	00	00	00	00	00	00	00
Totali		71	96	77	80	39	40	403

Tabela Nr. 3. Certifikatat e lëshuara:

50019 Certifikata								
N r	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtato r	Teto r	Nëntor	Dhjeto r	Total
01	Certifikata pronësie, (fleta poseduese)	287	314	176	366	200	61	1404
02	Kopje plani	37	39	40	38	60	17	231
03	Vërtetime të ndryshme	07	02	02	07	05	04	27
Totali		331	355	218	411	265	82	1662

Tabela Nr. 4. Punët e realizuara në fushën e pronësisë: Sektori i Pronësisë nuk është funksional me pensionim të zyrtarëve. Raportin në këtë dikaster ka z. A.Hashani

Pronësi								
Nr	Lloji i regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
01	Shpronësime	////	////	////	////	////	////	00
02	Uzurpime	///	///	///	///	///	///	00
03	Aktvendime	////	////	////	////	////	////	00
04	Të ndryshme	////	////	////	////	////	////	00
05	Ekspedicion	////	////	////	////	////	////	00
06	Servitut	////	////	////	////	////	////	00
07	Procesverbale	////	////	////	////	////	////	00
08	Të Bartura	////	////	////	////	////	////	00
09	Takime	////	////	////	////	////	////	00

	Total	////	////	////	////	////	////	00
--	-------	------	------	------	------	------	------	----

Paraqitja tabela e të hyrave për periudhën Janar-Maj 2023

Kategoria e të hyrave: Kadastër, Gjeodezi

Llogaria bankare në BQK: 1000650110000009

Nr.	Kodi	PËRSHKRIMI	SASIJA	VLERA
01	50504	Matjet në teren Azhurnime te lëndëve	403 kërkesa	12925 euro
02	50019	Trashëgimit, shitblerjet, hipotekat	5262kërkesa	14484 euro
03	50011	Certifikatat poseduese vërtetime dhe kopjet e planit	1580 kërkesa	6736 euro
Totali			6751 kërkesa	33785euro

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

AKTIVITETET I PARAPARË	REZULTATET E ARRITURA	KOHA E FILLIMIT	A ËSHTË MBYLLUR AKTIVIETI?	PERSONI/AT PËRGJEGJËS	MBËSHTETJA E NEVOJITUR
Mbikëqyrja e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe bashkëpunimi me njësinë	-Takime të rregullta pune me menaxhmentin e QKMF-së dhe akterët e tjerë relevantë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase në kujdesin parësor-shëndetësor për të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës pa dallim, përkatësisht, realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së;	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2. Dr.Latif Sylaj 3.Këshilli Drejtues i QKMF-së	Bashkëpunimi ndër-kolegial
Mbikëqyrja e Qendrës për Punë Sociale dhe bashkëpunimi me njësinë	- Takime të rregullta pune me Drejtorin e QPS-së, Udhëheqësen e Shërbimeve Sociale dhe Udhëheqësin e Asistencës Sociale, me qëllim të ofrimit të shërbimeve efikase sociale, familjare dhe të asistencës sociale, në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Kamenicës, rrjedhimisht realizimit të detyrave dhe objektivave të DShMS-së.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Rifat Hajdari	Bashkëpunimi ndër-kolegial
Mbikëqyrja e Shtëpisë së Komunitetit në Kamenicë dhe	- Takime të rregullta pune me Udhëheqësin e SHKK-së, në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuar mendore – ngecje në zhvillim mendor,	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Hajdin Krivaqa	Bashkëpunim ndër-institucional

bashkëpunimi me njësinë	sipas kërkesave të parashtruara nga organet përkatëse.				
Bashkëpunimi me Zyrën e Kryetarit, Kuvendin Komunal dhe drejtoritë e tjera në kuadër të komunës	-Takime pune me Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Shefin e Kabinetit, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Bordin e Drejtorëve etj; -Pjesëmarrje në seancat e Kuvendit Komunal;	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda	Bashkëpunimi me Kryetarin e Komunës dhe akterët e tjerë relevantë
Informata dhe sqarime për Aplikim për ndihmë financiare	-Ofrimi i informatave për palë dhe asistencës për aplikim për ndihmë financiare, e cila ndahet nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve nga lëmi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, i cili vepron pranë ZKA-së.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Stafi i DShMS-së	Bashkëpunimi me stafin e DShMS-së
Informata, sqarime dhe pranimi i aplikacioneve për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore-publike	-Ofrimi i informatave për mënyrën e aplikimit nëpërmjet DShMS-së, administrimi i dokumenteve relevante dhe aplikacioneve apo kërkesave për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore-publike.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Stafi i DShMS-së	Bashkëpunimi me stafin e DShMS-së
Planifikimi i rregullt i buxhetit për njësitë shpenzuese të DSHMS-	-Përgatitja e prioriteteve për buxhetin e DShMS-së 2023-2025.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda	Bashkëpunimi me zyrtarët financiar të DShMS-së

Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh)	-Donacion i veturës nga UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për QKMF-në -Donacion i Autoambulancës Ministria e Shëndetësisë për QKMF-në.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Latif Sylaj	Bashkëpunim ndërkolegial dhe ndërinstitucional
Bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)	-Koordinimi dhe bashkëpunimi i rregullt i njësive të DShMS-së me MFPT-në.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda	Bashkëpunim ndërkolegial dhe ndërinstitucional
Angazhimi i profesionistëve shëndetësor – Mjekëve Specialistë të fushave të ndryshme	- Angazhimi Pediatrit - Angazhimi i Radiologut - Angazhimi i Urologut - Angazhimi i Gjinekologut	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Latif Sylaj 3.Zyra e Kryetarit 4.Zyra e Personelit	Bashkëpunim ndërkolegial dhe ndërinstitucional
Shërbimet DDD në Komunën e Kamenicës	- Realizimi i shërbimeve të DDD-së në Komunën e Kamenicës	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2.Menaxheri i Kontratës	Bashkëpunim ndërkolegial dhe ndërinstitucional
Cilësia e ujit të pijshëm	- Në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjiçan është bërë testimi i mostrave të ujit në të gjitha shkollat e Komunës së Kamenicës.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda 2. Afrim Dërvishi	Bashkëpunim ndërkolegial dhe ndërinstitucional

				3.Qendra Rajonale e Shëndetit Publik-Gjilan	
Organizimi i kampanjave/fushatave senzibilizuese	- Fushatë senzibilizuese “Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit” ligjeratë nga Dr.Muharrem Sadiku; - Shpërndarja e broshurave dhe informatave nga personeli shëndetësor në të gjitha institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Kamenicës dhe në sheshin e qytetit; - Takime informuese dhe ligjerata senzibilizuese për sëmundjen e kancerit të gjirit. - Marsh në Sheshin e qytetit me moton “Zbulimi i hershëm-Mbijetesë”. - Shënimi i “Ditës botërore të Diabetit”; - Shënimi i “Ditës botërore të Zemrës”; - Karnavani shëndetësor për përmissimin e shëndetit dhe vetëdijësimin e qytetarëve për sëmundjet jo-ngjitëse në bashkëpunim me organizatën Syri i Vizionit; - Shënimi i “Ditës ndërkombëtare të infermierëve”.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda	Bashkëpunim ndër-kolegial dhe ndër-institucional

Realizimi i kontrollave sistematike për nxënës në shkollat e Komunës së Kamenicës	-Fillimi dhe finalizimi i projektit “Kontrollat sistematike në shkollat e Komunës së Kamenicës”. Çdo nxënës i shkollave fillore në Komunën e Kamenicës do të vizitohet nga ekipa mjekësore e po ashtu i’u dhurohet një pako e thjeshtë me produkte higjienike.	Korrik-Dhjetor		1.Eurona Hoda 2. Latif Sylaj 3. Afrim Dërvishi	Bashkëpunim ndërkolegial
Ushtrimi i kompetencave dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror	Në koordinim me stafin e DShMS-së, në mënyrë kontinuele i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në kuadrin e kompetencave tona, në funksion të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi në realizimin e misionit dhe objektivave të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.	Korrik-Dhjetor	/	1.Eurona Hoda	Bashkëpunim me stafin e DShMS-së
Aktivitete të tjera	- Takim me përfaqësuesit e Kujdesit Parësor Shëndetësor të 20 komunave primare, AQH Project; - Pjesëmarrje në punëtoritë e organizuara nga KShMS; -Takim me organizatën turke qeveritare “TIKA” me qëllim të informimit me të arriturat, sfidat dhe vështirësitë në lëmin e Shëndetësisë dhe	Korrik-Dhjetor	Po	1.Eurona Hoda	Bashkëpunimi ndërinstitucional

	Mirëqenies Sociale; -Pjesëmarrje në trajnime të tjera, punëtori dhe tryeza diskutimi me qëllim të ngritjes profesionale.				
--	---	--	--	--	--



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE

"Dr. Shaban Geci" KAMENICË

QKMF-KAMENICË Raport Statistikor I kontrollave ,shërb.shëndetsore për Gjashtemujorin e dytë-2023

Nr.	Lloji i shërbimeve	Mjekësi familjare	Urgjencja	Sherb. Pediat.	Punktet shëndetsore	Vizitat shtëpiak 0-	Sherb. Stomat.	Sherb.e Vaksin.	Mamografi	Gjinekologjia	Urologu	Sherb. R.T.G	Sherb. Labor.	Klasa për nëna	Totali
1	Kontrollimet mjekësore	16808	6625	2965	12599		1075	2077	1713	648	247				44757
2	Shërbimet medicinale	16983	26007	1709	12169	540	4542	3124	2670	648	247	2880	60006	242	131767
3	Vizita shtëpiake		228		72										300
4	Shërbimet shtëpiake	653	479		754										1886
	Total	34444	33339	4674	25594	540	5617	5201	4383	1296	494	2880	60006	242	178710

Të ref. jasht QKMF

2517

Të trajtuar serb

902

Kordinatorja

Kryeinfermierja

Drejtori i QKMF-së

Të trajtuar rom

265

Selvete Isufi

BSc.Nafije Ajvazi

Dr.Latif Sylaj

Të huaj

5

RAPORT STATISTIKOR I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE të QKMF-së,QMF,AMF-së për Gjashtemujori I dyte-2023

Nr.	Llojet e shërbimeve	M.Familja	Urgjenc	Pediatria	Punktet Shënd.	Vaksi-onimi	V.Shtëpiak e 0-3vjjet	Mamografi	Gjinekolog u	Urologu	Lab-Kamenic	Lab-Roga	Lab.Hog	RTG Kabinet	S.Kam	RTG-Stom	S.Rog	S.Hog	Klasa p	Ekipa n	Totali
1	Kontrollim mjeksore	16808	6625	2965	12599	2077		1731	648	247					886		101	88			44775
2	Shërbimet medicinale	16808	26007	1645	12169	3042	540	2670	648	247	36065	22906	1035	2880	3490	298	416	338	242		131446
5	V.Shtëpia ke		228		72															309	609
6	SH.Shtëpiake		479		754															987	2220
	Totali:	33616	33339	4610	25594	5119	540	4401	1296	494	36065	22906	1035	2880	4376	298	517	426	242	1296	179050
Nr.	Llojet e shërbimeve	Rogana	Hogosht	Karagevë	Koretin	Topanica	Sh.e lartë	Desivojcë	Muqiver	Strezovc	Kopermic	Krilevë	Tuxhe	Busavatë	Lisoc	Poli					Totali
1	Kontrollim et	11280	1316				3														12599
2	Shërbimet	9499	2158	43	227	11	231														12169
3	Vizitat shtëpiak	66	6																		72
4	Shërbimet shtëpiak	725	29																		754
	Totali:	21570	3509	43	227	14	231	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	25594
Nr.		Mjekësia familjare	Pediatria	Urgjenca	stomatologjia																
1	serb	675	45	145	37																
2	rom	126	44	80	15																
3	Të huaj	5																			
4	Të udhëzuar	1728	149	632	9																

SHËRBIMET SOCIALE

Gjatë periudhës gjashtëmujore në Shërbimet Sociale janë pranuar gjithsej dyqindetridhjetedy (232) kërkesa të reja, nga individ dhe institucione, të cilëve u janë ofruar shërbime profesionale nga ana e zyrtarëve të shërbimit social. Po ashtu, përveç rasteve të reja të paraqitura, për shkak të natyrës së punës sociale, në shërbim kemi punuar edhe me raste të vjetra të bartura nga viti i kaluar, por edhe nga vitet tjera paraprake.

Më poshtë do të paraqesim në mënyrë tabelore të gjitha rastet e reja të paraqitura sipas kategorive:

Tabela nr.1.

Nr.ren	Kategoria e klientëve	Numri i rasteve të reja
1	Fëmijë pa kujdes prindëror	2
2	Fëmijë të keqtrajtuar	2
3	Të miturit në konflikt me ligjin	12
4	Fëmijët me sjellje asociale	9
5	Fëmijët me aftësi të kufizuara	5

6	Çrregullime të marrëdhënieve bashkëshortore	12
7	Kërkesa për kontakte fëmijë-prind	1
8	Rastet e dhunës në familje	11
9	Personat me probleme mendore	2
10	Të moshuarit në nevojë për shërbime	1
11	Kërkesa për vërtetim për fitim shtetësie	29
12	Kërkesa për vërtetim për lënjen e shtetësisë	11
13	Kërkesa për vërtetime për zotësi veprimi	86
14	Pëlqime	1
15	Të tjera	3
16	Total	187

Komente

Përveç rasteve të reja, nga shërbimi janë trajtuar edhe rastet e bartura nga periudha e kaluar dhe vitet paraprake nga të gjitha kategoritë, ku në përgjithësi janë kryer këto shërbime:

- **Fëmijët pa kujdes prindëror.** Nga kjo kategori në këtë periudhë shërbime janë ofruar për tetëmbëdhjetë (18) fëmijë të vënë nën kujdestari, prej tyre pesëmbëdhjetë (15) kanë qenë të strehuar tek të afërmit e tyre të cilët për këtë shërbim marrin një pagesë mujore prej 150 euro, dy (2) fëmijë janë të vendosur në strehim familjar me pagesë 450 euro në muaj dhe një tjetër në familje.

*Fëmijët e strehuar tek të afërmit janë vizituar shumica prej tyre në familje dhe kemi pasur kontakte me kujdestarët e tyre ligjor. Për një rast kemi marrë pjesë në seancë gjyqësore sipas procedurës për alimentacion.

*Fëmijët e vendosur në familje strehuese janë vizituar në familje, kemi mbajtur kontakte të kohëpaskohshme me familjet edhe përmes telefonit për ta përcjellë gjendjen e tyre dhe për njërin rast i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore pasi familja strehuese ka kërkuar me ngulm ta largojmë nga andej, kemi zhvilluar procedurë për strehim rezidencial, duke organizuar aktivitete për kompletim të lëndës me kërkesë për nivelin qendror.

Nga kategoria e fëmijëve pa kujdes prindëror, vlen të ceket se gjatë kësaj periudhe kemi pasur dy kërkesa të reja të cilat janë proceduar nga shërbimi përmes caktimit të kujdestarit ligjor, pastaj janë nxjerr vendimet për strehim familjar dhe kontrata për strehim dhe të njejtat janë përfshirë në pagesë. Për njërin prej këtyre rasteve shërbimi ka iniciuar procedurë në gjykatë për ndryshim aktgjykimi lidhur me besimin e fëmijës personit të tretë, në këtë rast kujdestares së përkohshme ligjore/gjyshes.

Një rast është ndërprerë nga pagesa pas arritjes së moshës madhore.

Te delikuenca e të miturve gjatë kësaj periudhe kemi pranuar dymbëdhjetë (12) raste të reja të të miturve në konflikt me ligjin, prej tyre tetë (8) të paraqitura nga prokuroria për shkak të dyshimit të bazuar për kryerje të veprave penale nga të miturit dhe katër (4) nga gjykata për shkak të kryerjes së kundërvajtjes.

Rastet e dyshuara për vepra penale janë vizituar në familje ku zyrtarët e shërbimit kanë kontaktuar me të miturit dhe prindërit etyre me qëllim këshillimi dhe udhëzimi për përmirësim të sjelljeve. Po ashtu kemi asistuar edhe me rastin e intervistimit të tyre në stacionin policor.

Rastet që kanë kryer kundërvajtje po ashtu janë vizituar në familje ku janë këshilluar të miturit dhe familjet, dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme janë përgatit raportet hetuese sociale për gjykatë. Që të gjithë kanë qenë meshkuj të grup moshave 14-16 gjashtë raste dhe 16-18 gjashtë raste, shumica shqiptar, vetëm një serb.

Kemi pas nëntë (9) raste të reja të **fëmijëve me sjellje asociale**, shumica e rasteve të raportuara nga policia për shkak se janë nën moshën e përgjegjësisë penale, e të cilët është dashur të intervistohen nga QPS. Po ashtu disa prej tyre kanë qenë të raportuara nga shkolla për shkak të problemeve sociale të shfaqura në ambientet shkollore.

Sipas gjinisë pesë kanë qenë femra dhe katër meshkuj, nga nacionaliteti shqiptar shtatë raste dhe nacionaliteti rom dy raste.

Që të gjithë këta fëmijë, janë vizituar nga shërbimi, kemi punuar me familjet e tyre me qëllim përmirësimi të sjelljeve të fëmijëve, kemi bashkëpunuar me shkollat dhe policinë dhe kemi përgatit raporte me shkrim për nevoja procedurale të policisë.

Te kategoria e **fëmijëve me aftësi të kufizuara**, kemi pranuar pesë (5) kërkesa të reja nga prindër që kujdesen për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është mbajtur një seancë e vlerësimit nga Komisioni Mjekësor i shkallës së parë, ku janë prezantuar gjashtë (6) lëndë/kërkesa, prej tyre katër (4) janë aprovuar, një (1) ka mbet me plotësim dokumentacioni dhe një (1) ka munguar.

Të gjitha rastet e kryera, janë regjistruar në bazë dhe janë nxjerrë vendimet, për aprovim/refuzim të kërkesës dhe rastet e aprovuara janë përfshirë në pagesë.

Aktualisht në pagesë i kemi dyzetegjashtë (46) raste aktive.

Në kategorinë e **fëmijëve të keqtrajtuar** kemi punuar në dy (2) raste, që të dyja abuzimet dyshohen se kanë ndodhur jashtë shtëpisë, njëri nga fqinji dhe tjetri nga mësuesi në shkollë. Rastet janë vizituar në familje, në shkollë, kemi përgatit raporte dhe mendime për policinë dhe kemi bashkëpunuar me institucionet relevante.

Në kategorinë e **çrregullimeve bashkëshortore/besim i fëmijëve**, kemi pranuar njëmbëdhjetë (11) raste të reja, prej tyre gjashtëkërkesa nga gjykata për ndërmarrje të veprimeve të tentim pajtimit dhe dhënie të mendimit për besim të fëmijëve.

Këto raste janë kontaktuar, vizituar, këshilluar për sanim të raporteve ku kemi punuar me qëllim pajtimit, dhe meqenëse seancate pajtimit nuk kanë rezultuar të suksesshme, kemi përgatit mendimet për gjykatë lidhur me dhënien e mendimit për besim të fëmijëve njërit prind, kontaktim dhe alimentacion.

Përveç dhënies së mendimit me shkrim, zyrtarët/menaxher të rasteve ju kanë përgjigjur thirrjeve të gjykatës për pjesëmarrje nëseanca gjyqësore ku edhe gojarisht kemi dhënë mendimin dhe propozimin si në seanca përgatitore ashtu edhe në shqyrtim kryesor, gjithnjë deri në përfundim të procesit.

Në këto raste deri në marrje të vendimit meritohet nga gjykata, jemi angazhuar në ndërmjetësim me qëllim arritje të marrëveshjeve për kontaktim të prindërve me fëmijët e tyre.

Edhe në rastet e çrregullimeve, ku ende nuk ka mbërritur procedura në gjykatë, shërbimi është angazhuar në tentim pajtimi duke ofruar këshilla martesore dhe ndërmjetësuar në rregullimin e kontakteve me fëmijët.

Kemi punuar në njëmbëdhjetë (11) raste të **dhunës në familje**, që të gjitha raste të reja dhe një tjetër e përsëritur nga periudha paraprake.

Rastet janë paraqitur kryesisht nga policia përmes raportit ditor të dhunës në familje, por edhe nga prokuroria .

Nga shërbimi janë kryer vizita në familje, intervista me viktimat dhe familjar të tjerë, kemi përgatit mendime për gjykatë dhe kemi marrë pjesë në seanca gjyqësore.

Me kërkesë të prokurorisë kemi përgatit edhe raporte me shkrim lidhur me gjendjen ekonomike familjare të viktimave me theks të veçantë në nevojat e tyre.

Duhet cekur se në shumicën e rasteve viktimat janë gratë, vetëm një rast viktimë ka qenë i gjinisë mashkullore, edhe ai i nacionalitetit serb. Shkaktarë të dhunës, kryesisht janë bashkëshortët/burrat, një rast djali dhe nipi, dy raste babai dhe një rast vjehri. Shumica e rasteve janë shqiptuar, dy kanë qenë serb.

Në kategorinë e **kontakteve fëmijë prind** kemi pranuar kryesisht në raste të vjetra të bartura nga vitet paraprake dhe vetëm një rast i ri. Kryesisht shërbime janë kryer për dhjetë (10) raste, ku shtatë prej tyre kontaktet i mbajnë në QPS, ndërsa tre jashtë QPS, por pranim dorëzimi i fëmijëve bëhet përmes qendrës.

Rastet që kontaktojnë në QPS, shumica me vendime të gjykatës, takimet i mbajnë ka dy herë brenda muajit, ndërsa dy raste i kemi me nga katër takime brenda muajit, që do të thotë për çdo javë.

Kemi vizituar dy (2) **familje potenciale adoptuese**, me qëllim kryerje të procedurave të rivlerësimit. Familjet kanë përgatitur dokumentacionin e ri dhe është kryer procesi i rivlerësimit.

Kemi pranuar një kërkesë nga një person i cili si fëmijë është adoptuar nga QPS, i njëjti ishte i interesuar të marrë informacione lidhur me procesin e adoptimit të tij. Pas gjetjes së lëndës, pala është njoftuar mbi procesin e adoptimit, proces i kryer në vitin 1988.

Në kategorinë e **personave të moshuar**, kemi pasur vetëm një rast të ri, e moshuar pa përkujdesje familjare. E njëjta është vizituar dhe është njoftuar Kryqi i Kuq Komunal për ti ofruar ndihmë, sipas mundësive.

Kemi vizituar rezidentët tanë që i kemi të vendosur në SHPMPF në Prishtinë (gjithsej tre), ku jemi njoftuar për së afërmi me gjendjen e tyre

Në kategorinë **personave me retardime mendore** kemi vizituar klientët tanë që ndodhen të strehuar në Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Kamenicë ku jemi njoftuar me gjendjen e tyre të përgjithshme.

Kemi vizituar rezidentët tanë që i kemi të vendosur në ISSH, SHFSH dhe QIRSKP në Shtime dhe për dy raste e cilave ju ka skaduar afati i qëndrimit kemi përgatit propozimin për vazhdim të qëndrimit në ISSH.

Kemi pranuar një (1) kërkesë për **dhënie të Pëlqimit për pajisje me pasaportë** për fëmijën e prindërve të ndarë, ku pas vlerësimit të rastit, intervistës me palën, dokumentacionit të dorëzuar dhe dosjes paraprake që ndodhet në pasivë, kemi përgatit Pëlqimin për palën.

Shërbimi ka kryer edhe punë administrative; dhënie të vërtetimeve me kërkesë të klientëve, ku gjithsej janë lëshuar njëqindnjëzetegjashtë (126) **vërtetime**, njëzetënëntë (29) për fitim shtetësie, njëmbëdhjetë (11) për lirim nga shtetësia dhe tetëdhjetegjashtë (86) për posedim të zotësisë së veprimit.

Shërbimi ka menaxhuar bazat e të dhënave ku janë regjistruar me kohë rastet dhe janë dërguar me kohë të dhënat në DPSF, për administrim të pagesave dhe përcjellje të dukurive të shprehura në komunën tonë.

Kemi mbajtur lidhje të rregullta me DPSF-në duke dërguar, regjistrat e pagesave për fëmijët që ndodhen në strehim tek të afërmit dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe regjistrat për Panel për fëmijët potencial për strehim e adoptim dhe familjet potenciale strehuese e adoptuese në komunën tonë.

Pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga KPSHSF me qëllim marrje të kredive për rilicencim të zyrtarëve të shërbimevesociale, me temat si në vijim;

“Puna me migrant, të kthyer dhe të riatdhesuar”, trajnim treditör i mbajtur në Qerret/Durrës. “Fëmijët në Punë të Rënda dhe të Rrezikshme”, i mbajtur në Gjilan (Dy zyrtare të shërbimit).

“Puna me viktima të krimeve seksuale dhe trafikimit”, i mbajtur në Prishtinë. (Një zyrtare e shërbimit).

Aktivitete në kuadër të komisioneve komunale si; Komisioni për ndarje të subvencioneve në lëminë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komisioni për ndarje të subvencioneve për të porsalindurit, Komisioni për arkivim të dosjeve në DSHMS, Komisione për rekrutim të zyrtarëve publik, etj, ku një pjesë e madhe e kohës është shpenzuar në aktivitete lidhur me këto komisione

Bashkëpunimi me institucionet tjera si me policinë, gjykatat, prokurorinë, QPS-të homologe, QKMF-në, shkollat, OJQ dhe institucionet tjera komunale.

SEKTORI I NDIHMAVE SOCIALE

Në Shërbimin e Sektorit të Ndhimave Sociale në QPS-së Kamenicë, punojnë 4 Nëpunës të Ndhimave Sociale dhe Udhëheqësi i SHSNS. Në këtë shërbim punët dhe shërbimet për shfrytëzuesit e ndihmës sociale kryhen konform Ligjit mbi Skemën e Ndhmës Sociale 2003/15, Rregulloren Implementuese të këtij ligji, Ligjin nr.04/L-096 për ndryshimet dhe plotsimin e Ligjit 2003/15 për SNS, udhëzimeve dhe urdhërave administrative të nxjerra nga MPMS tani MFPT respektivisht DPSF-ja. Për të parë dhe analizuar punën SHSNS dhe për të dhënë komente duhet t'i paraqesim në mënyrë tabelare shenimet:

■ Numri i kërkesave të reja dhe të ripërseritura.

Muajt e Vitit2023	Kërkesat e reja		Ripërseritje		Të pranuar		Të refuzuara		Komente
	Kategoria		Kategoria		Kategoria		Kategoria		Shtesë
	I	II	I	II	I	II	I	II	
Korrik	1	3	1	0	2 k m +1 riaktivizim	1	2 k m	0	
Gusht	2	0	2	0	3 k m +2+3 riaktivizim	0	0	0	
Shtator	0	0	2	0	1 riaktivizim	0	0	0	
Tetor	0	1	4	2	1 riaktivizim	1+2 riaktivizim	4 k m	0	
Nëntor	2	2	0	1	1+3 k m +1 riktivixim	3	8 k m	0	
Dhjetor	2	1	3	0	1+3 k m	1	3	0	
Gjithsej	7	7	12	3	4+11 K M +6 riaktivizim	6+2 riaktivizim	17 k m	0	

k m – komisioni mjekësor (shkurtesat)

■ **Numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale dhe shuma e pagesës.**

Muajt e vitit 2023	Nr.familjeve	Pagesa mujore	Antarët e familjes	Komente shtesë
Korrik	410	49.700.00	1498	
Gusht	410	49.550.00	1496	
Shtator	409	48.810.00	1496	
Tetor	107	48.660.00	1496	
Nëntor	410	49.150.00	1512	
Dhjetor	?	?	?	
Gjithësejt				

■ **Numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale sipas kategorive dhe nacionaliteteve**

Muajt e Vitit 2023	Familje nr.		Pagesa shuma		Nr. i familjeve sipas nacionalitetit			
	Kat. I	Kat. II	Kat. I + II	shqiptar	serb	Rom	Malazez	Goran
Korrik	297	113	49.700.00	313	47	48	1	1
Gusht	303	107	49.550.00	310	49	49	1	1
Shtator	303	106	48.810.00	309	49	50	1	1
Tetor	?	?	48.660.00	?				
Nëntor	?	?	49.150.00	?	?	?	?	?
Dhjetor	?	?	?	?				
Gjithsej								

■ **Ndërprerja e ndihmave Sociale si dhe lëndët që kanë qenë në komision mjekësor për këtë periodë.**

Muajt e Vitit 2023	Ndërprerja e ndihmës sociale		Lëndët në Komision mjekësor në Gjilan				Komente shtesë
	K a t e g o r i a		Kategoria I				
	I-rë	II-të	gjith	poz	neg	rshqyr	
Korrik	1	2	23	23	0	0	
Gusht	1	5	7	7	0	0	
Shtator	2 atk +2	2	15	11	4	0	
Tetor	1	2	35	25	9	0	
Nëntor	1 k m	2	18	15	3	0	
Dhjetor	1	1	?				
Gjithësejt	6+1 k m +2 atk	14	98	81	17	0	

Shkurtesat: Atk – Agjensioni tatimor i Kosovës

Km – komisioni mjekësor

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - KAMENICË (DShMS)**Shtëpia e Komunitetit – Kamenicë(ShKK)****TABELA E KONTROLLIMEVE TË NDRYSHME SHËNDETSORE PËR REZIDENTËT E VENDOSUR NË SHTËPINË E KOMUNITETIT NË KAMENICË PËR PERIUdhËN JANAR- Dhjetor / 2023**

Trajtimet specialistike në Spitalin Rajonal të Gjilanit	Pastrim, lidhje – fashim ne institucion	Trajtimet specialistike në QKUK Prishtinë	Kontrollimet në QKMF në Kamenicë	Infuzione ,injeksione, në QKMF në Kamenicë	Analiza të ndryshme në QKMF në Kamenicë	Analizat ne S.R. Gjilan	Kontrollime psikiatrike	Trajtime ne institucione private
56	170	9	70	36	30	4	19	0

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë periudhës Janar- Dhjetor /2023 kemi pasur shumë trajtime dhe kontrollime, analiza të ndryshme mjekësore.

FURNIZIMI ME BARNA, USHQIM, MATERIAL HIGJENIK DHE TJERA

Furnizimi me barna: Gjatë kësaj periudhe të vitit kemi patur kontratë për furnizim me barna, ku operatori ekonomik na ka furnizuar me barna konform kërkesave tona. Andaj, mund të përfundojmë se kemi patur të gjitha barnat e nevojshme të cilat kanë qenë në kontratën për furnizime. Por sfida e jona mbetet si ti sigurojmë barnat emergjente të cilat nuk i kemi në kontratë, por në raste të ndryshme rekomandohen nga mjekët varësisht nga natyra e sëmundjeve apo rasteve emergjente.

Furnizimi me ushqim: Furnizimin me ushqim e kemi kontratën nga niveli qendror (AQP) ku është e shpërnadrë në disa Lote.Kompanitë kontraktuese na kanë furnizuar mirë dhe në pajtim me kërkesat tona.

Furnizimi me material higjienik: është bërë me kohë nga operatori ekonomik i kontraktuar dhe kemi pranuar maerialin sipaskërkesave tona, i cili ka qenë i mjaftushëm për mbajtjen e higjienës për rezident dhe institucionin në përgjithësi. Si konkluzionmund të nxjerrim se kemi patur materialin higjienik të mjaftushëm dhe cilësor për nevojat e institucionit.

Furnizimi me veshmbathje: Furnizimi me tekstil është bërë vitin e kaluar kurse per këtë vit kemi bërë kërkesë për furnizim nëzyrën e prokurimit por kërkesa jonë ende nuk është realizuar. Andaj, tani kemi vështërsi.

Furnizimi me material për mirëmbajtjen e ndërtesave: në gjashtëmujorin e parë nuk kemi patur kontratë për furnizime mematerial për mirëmbajtjen e ndërtesave, kurse tani kemi kontratën për furnizime dhe jemi furnizuar mjaftushëm për nevojat e opërgjithëshme për mirëmbajtjen e institucionit.

Shpenzimi i parasë së imët: Gjatë kësaj periudhe të vitit nga paraja e imët kemi shpenzuar 400.00 (katër qind) Euro, ku shumicën e mjeteve i kemi shpenzuar në servisimin e paisjeve të ndryshme në institucion dhe blerjen e medikamenteve. Mirëmbajten e parkut, mirëmbajtjen e paisjeve të shumta që i posedojmë, higjienën si të institucionit, pastrimin e rezidentëve, pastrimin e rrobave, mirëmbajtjen e kopshtit dhe çdo gjë tjetër është mirëmbajtur nga stafi i institucionit, duke u kujdesur 24 orënë ditë për të gjitha punët.

Vizitat nga familjarët dhe stafi i QPS-ve

Gjatë kësaj periudhe, vizitat nga familjarët e rezidentëve dhe nga përfaqsesit e QPS-ve kanë qenë me rregull.

Kërkesat për iniciimin e procedurave të prokurimit

- Kërkesë për furnizim me me veshmbathje dhe enë kuzhine (ka dështuar).
- Kërkesë për Shërbimet e DDD-së (është realizuar).

- Kërkesë për furnizim me barna dhe paisje mjekësor (është realizuar).
- Kërkesë për furnizim me material për mirëmbajtjen e objektit (është realizuar).
- Kërkesë për organizimin e ekskurzionit (është realizuar në dy pjesë).
- Kërkesë për furnizim me pemë dhe perime. (është realizuar).
- Kërkesë për furnizim me moblije, tavolina dhe dollape (Dy inicime të prokurimit kanë dështuar).
- Kërkesë për konsulent-psikiatër (ka dështuar).
- Kërkesë për furnizim me lavatriqe industriale (është realizuar).
- Kërkesë për marjen në shfrytëzim të pajisjeve aromatizuese (është realizuar).
- Kërkesë për asgjësimin e inventarit (është realizuar).
- Kërkesë për konkurs të rregullt (në procedurë).
- Dy kërkesa për angazhimin e dy zyrtarëve-shërbimet e veqanta (e realizuar).
- Kërkesë për furnizim me material hixhenik (në procedurë).
- Kërkesë për furnizim me pemë dhe perime (është realizuar).
- Kërkesë për atestet e rryfepritesit, tokëzimit, alarmit kundër zjarrit dhe servisimin e aparateve kunder zjarrit (është realizuar)-
Kërkesa për furnizim me tri ulëse treshe (kanape) -është realizuar.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor:

PËRSHKRIM I PUNËS PËR PERIUDHËN E RAPORTIMIT JANAR-DHJETOR 2023

Në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, stafi i kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë i angazhuar në këto aktivitete :

- Takime të rregullta pune me stafin e drejtorisë me qëllim të organizimit, planifikimit dhe koordinimit të punëve dhe detyrave që i kemi obligim.
- Shqyrtimin e çdo kërkesë për ndërtim në procedurë të rregullt administrative;

- Mbikëqyrja rreth ndërtimit, rindërtimit të infrastrukturës në tërë teritorin e Komunës së Kamenicës, investim nga buxheti dhe donacione të ndryshme,
- Pjesëmarja në komisionet për hapjen, vlerësimin e ofertave për ndërtimin e objekteve me interes të publik.
- Puna në Komisionin Komunal për shqyrtimin e ankesave për Taksat komunale .
- Puna në ekipën planifikuese (Planerët Urban), Ekipa Komunale për Planifiki Urban, Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZhK);
- Pjesëmarja në komisione për përgaditjen e akteve komunale – Rregulloreve komunale
- Pjesëmarja në trajnime, seminare të ndryshme të organizuara nga : MMPH-ë IKE –Asociaconi i Komunave të Kosovës, takime konsulente me organizatat të jashtme etj.
- Përgaditja/ nxjerrja e akteve-juridike dhe shkresave të ndryshme administrative;
- Konsultime të ndryshme me palë etj.

Në këtë periudhë kohore **Janar-Dhjetor 2023**, në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor janë pranuar gjithsej **(242)** kërkesa, ankesa dhe parashtrës të ndryshme:

- Kërkesa për leje ndërtimore (ndërtim, renovim etj.).....	67
- Kërkesa për leje rrenimi	4
- Kërkesa për caktimin e kushteve ndërtimore	57
- Kërkesa për vazhdimin e Vendimit për kushte ndërtimore.....	1
- Kërkesa për shfrytëzim të hapësirës publike (për ndërtim të perkohëshëm)	6
- Kërkesa për anulim të lejes për shfrytëzim të hapësirës publike (kioskë)	1
- Kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje	12
- Kërkesë, për ndërrimin e destinimit të tokës gjatë Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal	18

- Kërkesa për Ekstrakt, verifikim të destinimit të parcelës kadastrale në raport me dokumentet e planifikimit hapësinor që janë në fuqi	72
- Kërkesa për vërtetime të ndryshme (dëme te luftës, fatkeqësitë natyrore etj.).....	1
- Ankesa kundër vendimit të organit të shkallë së parë.....	3

Për kërkesat e shqyrtuara është vendosur:

-Pozitive	187
-Negative	6
-Në procedurë për shqyrtim.....	49

INICIMI I PROCEDURAVE PËR PROJEKTE TË INVESTIMEVE KAPITALE

Për vitin 2023 DUPH ka bërë iniciimin e procedurave për projekte të investimeve kapitale dhe shërbimeve si në vijim:

- Hartimi i projekteve LOT 1 dhe LOT 2,
- Ndërtimi i rrugëve me asfalt në qytet dhe fshatra dhe mbushja e gropave,
- Ndërtimi i trotuarëve në qytet dhe fshatra,
- Ndërtimi i urave metalike/beton për këmbësorë,
- Ndërtimi i urave të vogla nga betoni, zgjerimi dhe riparimi i urave ekzistuese,
- Ndërtimi i parqeve në Kamenicë - parku te amfiteatri i bulevardit, parku te qendra e vjetër
- Renovimi i ndërtesës sociale në Kamenicë.
- Inicimi i procedurave për rekrutimin e një konsulenti të jashtëm për hartimin e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të draftit të planit zhvillimor komunal.
- Ndërtimi i bulevardit të Qytetit në Kamenicë-punë të mbetura.

AKTIVITETE TJERA SHITESË NË KUADËR TË DUPH-së

- Përpilimi i planit të prokurimit për vitin 2023.
- Hartimi i specifikimit teknik të inventarit me qëllim unifikimin e modelit të inventarit për të gjitha shkollat e Komunës.
- Mbajtja e punëtorive gjatë hartimit të draftit të Planit zhvillimor të Komunës.
- Draftimi i Planit Zhvillimor Komunal përmes angazhimit të konsulentëve të planifikimit hapësinor, tani jemi në fazën e konsultimit me publikun për raportin e Vlerësimit strategjik Mjedior të PZHK-së, pas kalimit të afatit të konsultimit publik të raportit të VSM-së, do t'i dorëzojmë në MMPHI draftin e PZHK-së së bashku me raportin e VSM-së.
- Vizitë studimore në Austri e organizuar nga CNVP, për të parë nga afër sisteme të ngrohjes qendrore me biomasë, pasi që komuna e Kamenicës në bashkëpunim me CNVP-në ka përfutur një studim fizibiliteti për ndërtimin e ngrohjes qendrore të qytetit të Kamenicës, ku sipas studimit ka rezultuar që një investim i tillë do të ishte shumë fizibil, pasi që komuna posedon një sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve, nga ku mund të muret biomasa për të siguruar funksionimin e një sistemi të tillë të ngrohjes së qytetit.
- Vizualizimi i projektit të objektit të zjarrfikësave, për prezantim tek donatorët potencial për financim të ndërtimit të tij. Ky projekt ka qenë i gatshëm në formë fizike dhe në formatin pdf, por i ka mungu prezantimi 3D, prandaj, këtë pjesë të vizualizimit të projektit e kemi kryer ne.
- Pjesëmarrja në aktivitetin e USAID të quajtur, “Punëtorja konsultative-Kontrata Sociale” me zyrtarët komunal, për të identifikuar objektivat për pjesëmarrje publike dhe avancuar qasjen e institucioneve publike, në raport me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal.
- Aplikimi në thirrjen e lansuar nga MZHR “Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2024” (Investime kapitale). Lloji dhe tipi i projektit me të cilin kemi aplikuar e që është përzgjedhur nga ZKA ka qenë projekti “Qendra Zejtare” në qytet.
- Aplikimi në Ambasadën Japoneze për fondin prej 80 mijë euro të ndarë, me një projekt që ka të bëjë me blerjen e disa bicikletave elektrike që do të pozicionohen në qytet dhe do të mund të ipen me qera simbolike nga Komuna, për të interesuarit që duan të vizitojnë zonat rekreative turistike të Komunës së Kamenicës.
- Aplikimi në thirrjen e lansuar nga MZHR “Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2024” (Investime kapitale). Lloji dhe tipi i projektit me të cilin kemi aplikuar e që është përzgjedhur nga ZKA ka qenë projekti “Pritoret e Autobusëve nëpër fshatrat e komunës së Kamenicës”.
- Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga AZHR Lindje, me temën “Roli i nivelit lokal në promovimin e Agjendës së Gjellbër”
- Pjesëmarrja në punëtorinë me temën “Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike në nivel lokal” organizuar nga Asociacioni Kosovar për Energji të

Ripërtëritshme dhe Efiçencë të Energjisë – AKEREE.

PUNËT NË SEKTORËT E DUPH-së

-SEKTORI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Raporton:

i.d.a. Mehmet R. Thaçi

Përshkrimi dhe aktivitetet e punëve të realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023:

- Shqyrtimin e të gjitha kërkesave për kushte ndërtimore në procedurë të rregullt administrative;
- Shqyrtimin e të gjitha kërkesave /ekstrakteve pozita e parcellave me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), në procedurë të rregullt administrative;
- Shqyrtimin e të gjitha kërkesave/procesverbaleve, pëlqimeve për ndërtim sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), në procedurë të rregullt administrative;
- Konsultime të ndryshme me palë etj.
- Komisione për vlerësim të kandidatëve për në punë 1 procedurë rekrutuese
- Komisione të rregullta për vlerësim të ofertave në 4 procedura prokuruese

SHQYRTIMI I KËRKESAVE	Nr.
Ekstrakt	10
Vazhdim i lejës ndërtimore	
Informata e pozitës së parcellës në zonë jo urbane	
Procesverbale	
Caktimi i Kushteve Ndërtimore ; Shtëpi individuale , Restorante , shtalla etj.	
Pëlqime Urbanistike	5
Njoftime Publike	
Informata për kushte ndërtimore	7
Projekte Konceptuale	
Plotësim i Dokumentacioneve	
Refuzim	
Gjithsej	22

SEKTORI PËR LEJE NDËRTIMI, RINDËRTIM DHE INFRASTRUKTURË

Raportojnë:

1. I.d.n. **Hasan Rapuca**
2. M.sh.i.m **Muhamet Thaçi**
3. M.sh.ark. **Ilir Kastrati**

Përshkrimi dhe aktivitetet e punëve të realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, Në kuadër të Sektorit për Leje Ndërtimore, Rindërtim dhe Infrastrukturë:

Takime të rregullta pune në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor , me qëllim të organizimit, koordinimit dhe planifikimit për kryerjen e punëve dhe detyrave në kuadër të kompetencave të deleguara ligjore me të gjithë sektorët e Drejtorisë.

Shqyrtimin e të gjitha kërkesave për kushte dhe leje ndërtimi në procedurë të rregullt administrative; Shqyrtimin e të gjitha kërkesave për rindërtim, Ekstrakte, Letër Informata si dhe pozitën e parcelave mePDU, PZHK, PZHU dhe PRRU në procedurë të rregullt administrative;

Pjesëmarrja në seminare, trajnime, tryeza dhe takime pune të organizuara nga organizata të ndryshme ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare.

Puna me palë, konsultime profesionale sqarim nga fushëveprimi i ndërtimit urban dhe jo urban. Pjesëmarrja në komisione të ndryshme,

Shqyrtim i lëndëve të legalizimit.

Në kuadër të Sektorit për Leje Ndërtimore, Rindërtim dhe Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe është punuar sipas kësaj dinamike:

Shqyrtimi i kërkesave.

SHQYRTIMI I KËRKESAVE	
Leterinformatë	118
Ekstrakt	40
Njoftime publike	26
Pëlqime	4
Përgjigje në kërkesë	2
Llogaritja e taksave ndërtimore	48
Kushte ndërtimore	23
Leje ndërtimi	62
Leje Rrënimi	3
Komision të vlerësimit për dëmet nga fatkeqësitë natyrore	6
Komision të vlerësimit për pranim të kandidatëve në shërbimin civil	1
Vlerësim i projekteve konceptuale	30
Vlerësim i projekteve ideore	39
Vlerësim i projekteve kryesore për infrastrukturë	48
Refuzim i projekteve konceptuale	1
Refuzim i projekteve ideore	6
Refuzim i projekteve kryesore	4
Shqyrtim i kërkesave për Legalizim të objekteve	27
Menaxhim i projekteve	6
Mbikçyrje e projekteve	3
Punimi i projekteve për renovim të objekteve banesore në qytetin e Kamenicës	12
Përgaditja e projekteve dhe futja në sistemin PIP	50
Vlerësimi i Ofertave – zyra e Prokurimit	4
Takime Konsultative me palë	52
Arkivimi i dokumentacionit të DUPH-së	54
Vërtetim për dëmet e shkaktuara nga tërmeti 2002	1
Gjithsej	670

Numri i përgjithëm i shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave nga ky sektor është gjithsej 670 lëndë.

SEKTORI I NDËRTIMIT

Raporton:

i.d.n. **Shaban Kastrati**

- Takime, konsultime profesionale me kolegët në DUPH.
- Kontrollimet dhe aprovimet e projekteve të dorëzuara në DUPH nga ana e Kompanisë Projektuese.
- Kontrollimet dhe aprovimet e projekteve të dorëzuara në DUPH nga palët tjera.
- Vizita në disa objekte në fazën e ndërtimit (konsultime).
- Takime dhe konsultime me përfaqësuesit e MMPH dhe Infrastrukturës në lidhje me PZHK-në.
- Përpunimi i projekteve të investimeve kapitale. P I P për periudhën 2023-2025.
- Vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe zjarret në objekte ndërtimore.

Raporton:

i.d.h. **Mexhid Zylfiu**

Zyrtar i lartë për Hidrondërtimtari

- Anëtar i komisionit për shqyrtimin e kërkesave në shfrytëzim të hapësirave publike në Kamenicë
- Anëtar i komisionit për vlerësim të ofertave në 6 procedura prokuruese.
- Kryetar i komisionit për vlerësim të ofertave në 14 procedura prokuruese.

Raporton:

Zyrtar i lartë Ligjor Jur.dip. **Arif**

Skoverqani

Përshkrimi dhe aktivitetet e punëve të realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023

-Puna në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I-rë dhe II-të.

-Pjesëmarrja në komisionet për vlerësimin e ofertave për ndërtimin e objekteve me interes të përgjithshëm,

-Pjesëmarrja në komisionin për Riatdhesim- Riintegrim.

-Puna në Komisionin Komunal për shqyrtimin e ankesave për taksat komunale për personat juridik që shvillojnë biznes në teritorin e komunës së Kamenicës.

-Puna në Komisionin Komunal, pjesa Taksat administrative për Leje Ndërtimore, Leje rrënimi dhe Tarifa Rregullative për rritjen e densitetit të Infrastrukturës për kategorinë I-rë dhe II-të të ndërtimeve.

-Puna në Komisionin Komunal, pjesa Taksat administrative për Leje Ndërtimore, Leje rrënimi dhe Tarifa Rregullative për rritjen e densitetit të Infrastrukturës për kategorinë I-rë dhe II-të të ndërtimeve.

Bch Geod.Mimoza Fejzullahu

Gjate vitit 2023 ka qenë në pushim të lehonisë, për momentin gjendet në pushim pa pagesë.

KONTRATAT-PROJEKTET QË MENAXHOHEN NGA ZYRTARËT E DUPH-së:

Mehmet R.Thaçi menaxhon-mbikëqyr këto projekte-kontrata:

- **Menaxhimi i kontratës** “Ndërtimi i sistemit të ujitjes automatike për parkun e qytetit dhe ndërtimi i qeshmeve”. Menaxhimi i kontratës “Ndërtimi i pritoreve të autobusëve”
- **Menaxhimi i kontratës** “Renovimi i AMF-së në fshatin Busavatë”
- **Menaxhimi i kontratës** “Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes dhe klimatizimit”
- **Mbikqyrës i drejtëpërdrejt i Menaxherit të kontratës** me titull “Investimi dhe Ndërtimi i kolektorit për ujëra të zeza në Hogosht dhe Shipashnicë”

Hasan Rapuca menaxhon-mbikëqyr këto projekte-kontrata:

- **Mbikqyrës i drejtëpërdrejt i Menaxherit të kontratës** me titull “Hartimi i projekteve LOT 1 dhe LOT 2”
- **Menaxher i kontratës** “Mirëmbajtja e kanalizimit dhe infrastrukturës të komunës së Kamenicës”.
- **Menaxher i kontratës** “Ndërtimi i urave të vogla nga betoni, zgjerimi dhe riparimi i urave ekzistuese në Roganë etj”
- **Menaxher i kontratës** “Ndërtimi i parkut në qendrën e vjetër të qytetit” Operatori nuk ka filluar me punë mbrenda afatit të paraparë me kontratë dhe menaxheri ka rekomanduar zyrës së prokurimit për shkëputjen e kontratës.
- **Menaxher i kontratës** “Ndërtimi i tereneve sportive të institucioneve arsimore Roganë” Kontratë e ndërperë për shkak se OE nuk ju ka përmbajtur kontratës dhe afateve ligjore të planit dinamik të kryerjes së punëve.

Ilir Kastrati menaxhon-mbikëqyr këto projekte-kontrata:

- **Menaxher i kontratës** “Shërbimet e konsulencës – Konsulent, ekspert për vlerësimin strategjik mjedisor – Ritenderim 3”

Muhamet Thaçi menaxhon-mbikëqyr këto projekte-kontrata:

- **Mbikqyrës i drejtëpërdrejt i Menaxherit të kontratës** me titull “Shërbimet e konsulencës – Konsulent, ekspert për vlerësimin strategjik mjedisor – Ritenderim 3”.

Mexhid Zylfiu ka menaxhuar -mbikëqyrë këto projekte-kontrata:

- **Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës** "Projekti për shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht-Lisockë në komunën e Kamenicës nga skema e grantit për performancë komunale"Projekt në realizim.
- **Menaxhimi i kontratës** : Ndërtimi i kanalizimit në Shipashnicë të Epërme, projekt në realizim.
- **Menaxher i kontratës** "Hartimi i Projekteve LOT 1 dhe LOT 2".
- **Menaxher i kontratës** "Rregullimi i shtratit dhe zonave të degraduara të lumit Desivojcë-Shipashnicë Komuna e Kamenicës.
- **Anëtar i ekipës menaxhuese për kontratën** "ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë dhe fshatra" ritenderim.
- **Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës** "ndërtimi i bulevardit të Qytetit në Kamenicë-punë të mbetura.

Gjatë këtij viti në kuadër të Lot-it 1 të kësaj kontrate janë projektuar këto objekte si në vijim:

Projektimi i objekteve ndërtimore	
Emërtimi i projektit	Sasia e projektuar
Parkingu i gjelbër në qendër të Qytetit të Kamenicës	2847m ²
Renovimi i shkollave	572.4m ²
Parku te qendra e vjetër në Kamenicë	1388m ²
Pritoret e autobusëve	293m ²

Gjatë këtij viti në kuadër të Lot-it 2 të kësaj kontrate janë projektuar këto objekte si në vijim:

Projektimi i objekteve ndërtimore	
Emërtimi i projektit	Sasia e projektuar
Ndërtimi i urës metalike për këmbësorë në Koretin	420m ²
Ndërtimi i urës metalike për këmbësorë në Hajnoc	400m ²
Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në K. e Kamenicës	5070m'

Ndërtimi i rrjetit të ujësjetllësit në fshatin Karaqevë e Epërme të K.Kamenicës	15694.58m'
Ujërat atmosferike në lagjen Çamëria	219m'
Kanalizimi Fekal dhe Atmosferik në Roganë	460.38m'
Ndërtimi i murit mbrojtës në Ship. të Poshtme	112m ²
Ndërtimi i pendës për ujitje në Muçiverc	3342.41m'

Raporti i punës në gjashtëmujoreshin e dytë të DZHED-së

100 mijë eurosh 38 biznese përfituese të grantit komunal , 11 prej tyre janë biznese të reja Start up-e kurse 27 ekzistuese.

2. Panairi i prodhimeve vendore 2023!

3.Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal

6. Hartimi i rregullores së re për rregullimin e orarit të punës së veprimtarive biznesore.

7. Inicimi për bashkëpunimin në projektin e kontratës sociale me USAID-in

8. Projekti business friendly certificate Instituti Riinvest, Certifikimi i komunës për një ambient të përshtatshëm biznesor.

10.Takim me z.Qëndrim Hoxha, Drejtori Ekzekutiv (CEO) për degën në Kosovë, në organizatën ndërkombëtare “Leadership Development Association Europe” (LDA Europe).

11.Panairi për nder të Ditës së Flamurit, 28 Nëntorit

12.Në bashkepunim me drejtorinë e bujqësisë projekt i përkrahur nga UN Kosova dhe Komuna e Kamenicës, ndërtimi i kapaciteteve digjitale për gra fermere, veglat digjitale në agrobiznes.

13. Letra e Bardhë

14. Udhëzuesi për biznese

15. Profili ekonomik

16.Bashkë inicuese për themelimin e shoqatës së bizneseve

16.Trajnime për biznese dhe të rinj

17 Shenjëzimi i fanarit

18. Mbështetja e bizneseve në panairin ndërkombetar Agrokos

19. Strategjia e Turizmit në diskutim publik

Drejtoria për Buxhet dhe Financa:

Raporti i punës për Korrik-Dhjetor 2023 i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, ka qenë i hartuar në atë mënyrë që të përmbush objektivat dhe kërkesat e Qeverisë Komunale, duke pasë gjithëherë si objektivë respektimin e Ligjeve dhe Rregulloreve Komunale si:

- LMFPP,
- Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal,
- Ligjin mbi vetëqeverisjen Lokale,
- Urdhëresat, rregulloret dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave,

- Ligjin e tatimit në pronën e palujtshme,
- Rregulloren për Taksa,Tarifa dhe Gjoha komunale.

Misioni-Drejtoria për Financa dhe Buxhet menaxhon buxhetin e Komunës dhe ju ofron:

- Informata ,shërbime për drejtoritë me të dhënat e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve;
- Informon ZKA-në me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e Komunës;
- Përgatitë materiale-Rregullore për KPF dhe Kuvend Komunal;
- Kontrollon menaxhimin e financave komunale;
- Bën përgatitjen dhe prezantimin e buxhetit;
- Bënë koordinimin me punët dhe aktivitetet e drejtorisë në kuadër të Sektorit për Buxhet dhe Financa;
- Këshillon zyrtarët komunalë për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat
- Inskason të hyra nga Tatimi në Pronë
- Inskason të hyra nga taska komunale dhe qeraja

Numri i aprovuar i punëtorëve është 25, nr.aktual i punëtorve është 22 në të gjithë sektorët e Drejtorisë, sektorë të cilët japin kontribut të madh në dhënien e këshillave për organizime të ndryshme që kanë të bëjnë me buxhet apo për dëgjime dhe forma tjera të organizimeve.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të Drejtorisë e të cilat kryhen në koordinim edhe me Zyrtarin Kryesor Financiar janë:

- Fillimi i implementimit të qarkoreve buxhetore,
- Organizimi i takimeve me drejtorë për planifikimin e buxhetit në drejtoritë përkatëse,
- Organizimi dhe mbajtja e debateve dhe dëgjimeve buxhetore rreth planifikimit të buxhetit për vitin 2024-2026, dhe marrja në konsideratë e kërkesave të qytetarëve,
- Përgatitja e gjithë dokumentacionit relevant për Kuvend për aprovim të buxhetit.
- Dorëzimi i materialeve në Ministri të Financave, pas aprovimit në KK
- Komunikim të rregullt me Ministrinë e Financave.
- Hartimi dhe përgatitja e raporteve periodike për KK, sipas ligjeve në fuqi, etj.

- Takime me Kryetarin dhe Kryesuesin për planifikim të buxhetit
- Përgatitje të materialit për mbajtjen e dëgjimeve publike me qytetarët rreth KAB 2024-2026
- Përcjellje e regjistrimit të E-pasurisë dhe projekteve
- Regjistrimin e investimeve kapitale në FREE BALANCE
- Përgatitja e shpërndarjes së të hyrave vetanake mujore për alokim dhe harmonizimi i të hyrave sipas planifikimit të buxhetit 2023
- Azhurimi i pagesave
- Analizë dhe Raportim për mjetet e alokuara dhe nënalokuara sipas muajve
- Përditësimi i Planit të Keshit për shumën e kërkuar nga fondi 21
- Kërkesa për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK
- Regjistrimi i të hyrave
- Procesi i Pajtueshmërisë të regjistrit kontabël në SIMFK
- Barazimin ditor me ministri të financave dhe BQK

Në kuadër të Drejtorisë funksionojnë disa sektorë, ata janë:

1. Sektori i Buxhetit,
2. Sektori i Financave,
3. Sektori i Tatimit në Pronë dhe
4. Zyra e Thesarit.

SEKTORI I BUXHETIT

Tabela e Planifikimit të Buxhetit për vitin 2023-Drejtoria për Financa dhe Buxhet

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance
PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)
17529 BUXHETI - KAMENICË	196,999.91	180,396.49	16,603.42	170,375.81	820.12	25,803.98
11 PAGA DHE SHTESA	171,999.91	155,396.49	16,603.42	146,258.11	0.00	25,741.80

13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	24,117.70	820.12	62.18
Totali I Përgjithshëm	196,999.91	180,396.49	16,603.42	170,375.81	820.12	25,803.98

Tabela e realizimit/Inkasimit të të hyrave për periudhën gjashtëmuajore Korrik-Dhjetor 2023

Përshkrim	Debiti	Kredit
Valutë : EURO (€)		
SPROG / LITEM		
17529 - BUXHETI – KAMENICË	132.00	238,267.46
40110 - TATIMI NË PRONË	132.00	194,177.40
50006 - TAKSA PËR REGJISTRIM BIZNESI	0.00	24,634.50
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	0.00	19,455.56
Total Balance	132.00	238,267.46

Tabela e shpenzimeve Korrik-Dhjetor 2023

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Parashikimi vjetor
PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
17529 BUXHETI - KAMENICË	196,999.91	180,396.49	16,603.42	170,375.81	820.12	25,803.98	86.49
11 PAGA DHE SHTESA	171,999.91	155,396.49	16,603.42	146,258.11	0.00	25,741.80	85.03
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	24,117.70	820.12	62.18	96.47
Totali I Përgjithshëm	196,999.91	180,396.49	16,603.42	170,375.81	820.12	25,803.98	86.49

Tabela e Të hyrave të inkasuara sipas muajve për vitin 2023 krahasuar me planifikimin fillestar në nivel komunal

Periudha	Dënime t në trafik	Gjobat nga gjykatat	Agjensi oni nga pyjet	Total Denimet + Gjobat	Raporti SIMFK	Realizimi I planit	Plani për vitin 2023	rritja e te hyrave 12.12.2023	rritja e te hyrave
	a	b		c	d	e=c+d	f		
Janar	12,445.00		-	12,445.00	82,138.12				
Shkurt	11,210.00		-	11,210.00	63,168.79				
Mars	12,055.00			12,055.00	108,664.27				
Prill	7,725.10			7,725.10	213,501.47				

Maj	13,257.00			13,257.00	170,021.61				
Qershor	10,105.00			10,105.00	85,348.80				
Korrik	10,395.00			10,395.00	81,832.13				
Gusht	16,931.00			16,931.00	102,755.49				
Shtator	11,035.00			11,035.00	71,976.39				
Tetor					78,429.14				
Nëntor					43,687.11				

Dhjetor					12,076.52				
Total	105,158.10			105,158.10	1,113,599.84	1,218,757.94	956,771.00	261,986.94	127.38

Nga tabela shihet se bazuar në planifikimin e të hyrave për vitin 2023 deri me datën 12.12.2023 realizimi tejkalohet për 27.38 %

Tabela e shpenzimit te buxhetit per vitin 2023 krahasuar me buxhetin aktual në nivel komunal:

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)
11 PAGA DHE SHITESA	7,988,229.88	7,781,255.10	206,974.78	7,947,623.34	0.00	99.49
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,022,568.07	2,022,568.07	0.00	1,516,349.90	465,449.70	74.97

14 SHPENZIME KOMUNALE	239,095.96	239,095.96	0.00	181,449.67	36,849.82	75.89
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	646,596.99	646,596.99	0.00	581,795.14	41,154.95	89.98
30 PASURITË JOFINANCIARE	2,728,925.68	2,728,925.68	0.00	1,386,047.52	1,311,261.65	50.79
Totali I Përgjithshëm	13,625,416.58	13,418,441.80	206,974.78	11,613,265.57	1,854,716.12	85.23

Nga tabela shihet se deri me datën 12.12.2023 realizimi I buxhetit duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve është 85.23%.

SEKTORI I FINANCIVE

Me këtë raport ju informojmë për të hyrat e planifikuara dhe inkasuara nga ngarkesat – taksat komunale dhe qiraja për periudhën 01.07.2023 - 08.12.2023.

Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave nga Sektori i Financave për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Taksa mbi veprimtarinë e bizneseve është tatim i detyrueshëm dhe i pakthyeshëm i cili grumbullohet në buxhetin e institucioneve komunale duke u mbështetur në Rregulloren Komunale si dhe Ligjin për Vetqeverisje Lokale. Taksat paguhen nga çdo person juridik i cili ushtron veprimtari fitimprurëse në territorin përkatës e që është i regjistruar në zyrën e regjistrimit të bizneseve si dhe i pajisur me leje të punës nga Inspektorati Komunal.

Duhet të cekim se në periudhën e dytë të vitit 2023 kemi bërë edhe planin për inkasimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u mbështetur në të dhënat e pasqyruara, Sektori i Financave ka hartuar planin konkret se si të veprojmë dhe hapat që duhet të ndërmeren për inkasim të detyrueshëm, gjithnjë duke u mbështetur në Rregulloren Sh.01 Nr.5300 të datës 16.02.2023 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale si dhe Ligjin mbi Mardhëniet Detyrimore.

N r	Muajt	Taksa komunale		%	Çiraja		%	Gjithsej inkasuar
		Plan.2023	Rea.2023	3/2	Pla.2023	Rea.2023	6/5	3+6
	1	2	3	4	5	6	7	8
1	Korrik	5000.00	6430.00	128.60	3300.00	2,400.00	72.72	8,830.00
2	Gusht	5000.00	5634.50	112.69	3300.00	2,750.00	83.33	8,384.50
3	Shtator	5000.00	6507.50	130.15	3300.00	2,400.00	72.72	8,907.50
4	Tetor	5000.00	3720.00	74.40	3300.00	9,245.54	280.16	12,965.54
5	Nëntor	5000.00	2207.50	44.15	3300.00	2,400.00	72.72	4,607.50

6	Dhjetor	1333.00	665.00	49.88	880	00	0	665.00
	Gjithsejt	26,333.00	25,164.50	95.56	17,380.00	19,145.54	110.44	44,360.04

Në mënyrë tabelare do t'i paraqesim planifikimin dhe realizimin për periudhën Korrik-Dhjetor(01.07.2023-08.12.2023) të vitit 2023:

Numri i shoqërive tregtare të ngarkuara me taksë komunale për vitin 2023 është 233 shoqëri tregtare, në bazë të vendimeve të lëshuara nga Drejtoria për Financa dhe Buxhet. Vlera e këtyre ngarkesave kap shumën prej **64,045.00 €** duke përfshirë zbritjen prej 10% për 104 biznese përfituese në bazë të Rregullores.

Planifikimi për taksa komunale mbi shoqëritë tregtare për gjashtëmujorin e dytë (01.07.2023-08.12.2023) të vitit 2023 është **26,333.00 €**, ndërsa realizimi deri në këtë periudhë kohore është **25,164.50 €**, ose shprehur në përqindje **95.56 %**.

Planifikimi për taksa nga qiraja për objektet afariste, banesore dhe tokave bujqësore për periudhën e gjashtëmujorit të dytë (01.07.2023-08.12.2023) të këtij viti ka qenë **17,380.00 €**, ndërsa realizimi deri në këtë periudhë kohore është **19,145.54 €** ose shprehur në përqindje **110.44 %**.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, sektori i financave nga inkasimi i taksave nga subjektet afariste dhe qiraja e objekteve afariste, banesore dhe tokave bujqësore, ka grumbulluar shumën prej **44,360.04€**. Duhet të theksojmë që borxhi i përgjithshëm i subjekteve afariste prej viteve paraprake deri me datën 08.12.2023 është **375,619.82 € dhe parapagesa në vlerë prej 697.20 €** dhe nëse e krahasojmë me vitin e kaluar ku borgji i përgjithshëm ishte **393,077.57€ dhe parapagesa në vlerë prej 811.20€**, kemi rënie të borxhit të përgjithshëm prej **17,457.75€** apo **4.45 %**.

Borxhi i mbetur nga qiraja e objekteve afariste,banesore dhe tokave bujqësore deri më 08.12.2023 është **50,842.12 €** si dhe parapagesë **51.00 €**.

Në tabelën më poshtë do të paraqesim në mënyrë tabelare të hyrat nga taksat komunale mbi bizneset dhe qiraja për periudhën 01.07.2023-08.12.2023 sidhe krahasimet me periudhën e njëjt të vitit paraprak.

N r	Muajt	Tak. Komunale		Tak. Komunale		%	Qiraja		%	Gjithë sej Inkasi mi 2022	Gjithë sej Inkas uar 2023	%
		Pla. 2022	Rea.2 022	Pla.2 023	Rea.2 023	5/3	Rea.2 022	Rea.2 023	8/7	3+7	5+8	11/10
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Korrik	5000.00	5,829.50	5000.00	6430.00	110.30	2750.00	2400.00	87.27	8579.50	8830.00	102.91
2	Gusht	5000.00	5,080.00	5000.00	5634.50	110.91	2750.00	2750.00	100.00	7830.00	8384.50	107.08
3	Shtator	5000.00	1,315.00	5000.00	6507.50	494.86	2750.00	2400.00	87.27	4065.00	8907.50	219.12
4	Tetor	5000.00	4,035.00	5000.00	3720.00	92.19	2400.00	9245.54	385.23	6435.00	12965.54	201.48

5	Nëntor	5000.00	6,879.00	5000.00	2207.50	32.09	4265.25	2400.00	56.26	11144.25	4607.50	4.34
6	Dhjetor	5000.00	6,865.50	665.00	665.00	9.68	2750.00	00	00	9615.50	665	6.91
	Gjiths.	30000.00	33,104.00	26,333.00	25,164.50	76.01	17,665.25	19195.54	108.66	50769.25	44,360.04	87.37

Gjatë vitit 2023 deri me datën 08.12.2023 kemi hartuar 12 kontrata për riprogramim të borxhit sa I përket taksave komunale.

SEKTORI I TATIMIT

NË PRONË

Sa i përket sektorit të tatimit në pronë, disa nga aktivitetet kryesore që kryhen në këtë sektor janë:

- Shpërndarja e fatura tatimore
- Regjistrimi i objekteve të reja
- Krijimi i një evidence të mirëfilltë me emrin e obliguesit dhe numrin e formularit duke I klasifikuar nëpër zona tatimore
- Shqyrtimi i ankesave
- Monitorimi i pagesave me këste
- Rianketimi i pronave
- Dhënia e vërtetimit për pagesat në Tatim në Pronë
- Inkasimi i detyruar

Gjatë periudhës 1 korrik 2023 deri me datë 11 dhjetor 2023 kemi rezultate të konsiderushme në këtë sektor. Në tabelën mëposhtme po i paraqesim statistikat për këtë periudhë:

Nr.	Aktiviteti	Rezultati
1.	Regjistrimi i objekteve të reja	523 objekte
2.	Rianketimi i objekteve	759 objekte
3.	Certifikata të pagesës për obligues tatimor	1522 çertifikata
4.	Vendime për përmbnim	12 vendime
5.	Njoftime përfundimtare të dërguara	242 njoftime

6.	Hartimi i kontratave për pagesë me këste	26 kontrata
----	--	-------------

Ndërsa sa i përket periudhës prej 01.01.2023 e deri me datën 08.12.2023 kemi këto statistika që do ti paraqesim në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Aktiviteti	Rezultati
1.	Regjistrimi i objekteve të reja	717 objekte
2.	Rianketimi i objekteve	920 objekte
3.	Certifikata të pagesës për obligues tatimor	4384 çertifikata
4.	Vendime për përmbarim	12 vendime

5.	Njoftime përfundimtare të dërguara	242 njoftime
6.	Hartimi i kontratave për pagesë me këste	102 kontrata

ZKTP ka filluar lidhjen e kontratave me tatim paguesit nga vitit 2022 dhe deri me sot janë lidhur gjithsej 236 kontrata.

Për periudhën Janar – Qershor 2023 janë lidhur gjithsej 76 kontrata, ndërsa për periudhën Korrik 2023 e deri me sot janë lidhur gjithsej 26 kontrata.

KRAHASIMI I TË HYRAVE DHE BORXHIT PËR VITIN 2022/2023

NR.	PËRSHKRIMI	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Planifikimi 2023	Realizimi 2023	% e realizmit 2022/2023
1	Të hyrat	502,648.00	491,523.17	535,046.00	579,005.21	17.8% rritje
2	Borgji për objekte	/	1,384,905.03	/	1,228,475.62	Zvogëlim 11.3%

3	Borgji për parcela	/	293,799.98		374,440.25	Rritje 27%
4	Borgji i përgjith.	/	1,676,977.18	/	1,602,915.90	Zvogëlim 4.5 %

Borxhi i përgjithshëm për objekte deri më 2022 ka qenë 1,384,905.03 euro, ndërsa në këtë vit është 1,228,475.62 euro .

Pra, kemi zvogëlim të borxhit për 156,429.41 euro për objekte.

Borxhi i përgjithshëm për parcela është 374,440.25, ndërsa për vitin 2022 ishte 293,799.98 euro, pra, kemi rritje të borxhit për parcela 80,640.27 euro.

Nga gjithë kjo del se borxhi i përgjithshëm deri me datën 12.12.2023 është 1,602,915.90 euro, ndërsa në vitin 2022 borxhi i përgjithshëm ishte 1,676,977.18 euro që nënkupton se kemi zvogëlim të borxhit.

Vlenë të theksohet se edhe pas pezullimit të RREGULLORES (QRK) NR.07/2021 MBI PEZULLIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TË PAPAGUARA TË TATIMIT NË PRONË në shërbime prapë kemi zvogëlim të borxhit për 73,961.28 euro.

SEKTORI I THESARIT

Ky raport pasqyron punën e zyrës së thesarit për disa nga aktivitetet thelbësore për gjashtëmuajorin e dytë 2023. Në këtë raport janë të pasqyruara punët dhe aktivitetet të ndërmarra në këtë zyrë, i cili synon të paraqesë një pamje të qartë të punës të ndërmarrë, si kundër edhe problemeve e pengesave që zyra ka hasur në këtë periudhë. **Gjatë kësaj periudhe zyra ka pasur sfida të shumta, megjithatë puna rezultoi e saktë dhe e suksesshme.** Zyra Thesarit vepron si njësi e Drejtorisë Financa dhe Buxhet, e cila merret me procedimin e lëndeve për pagesë, duke përfshirë të gjitha Drejtoritë e Administratës Komunale, Dka-së Qps-së dhe Qkmf-së. Kjo zyrë funksionon nga data 11.09.2009 kur Minisria e Financave merr vendim për decentralizimin e Thesarit Regjional në Zyra Komunle.

Në vazhdim po paraqesim një raport përmbledhës Korrik-Dhjetor, duke marrë si bazë elementet thelbësore pa nxjerrë elemente të detajuara për procesimin e shpenzimeve në Komunë, duke përfshirë të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës.

Periudha e raportimit: Korrik-Dhjetor 2023

	Përshkrimi	Nr.i lëndëve/shuma në euro
1	Vlera e shpenzimeve Korrik-Dhjetor 08.12.2023 (pa kategorinë e pagave)	3,593,737.66
2	Mallra dhe Shërbime	1,005,928.09
3	Shpenzime Komunale	85,329.85
4	Subvencione dhe transfere	369,757.14
5	Shpenzime Kapitale	1,055,491.60

6	Vlera e avanseve të hapura per udht.zyrtare	2,494.29
7	Vlera e avanseve tëmbyllura për udhëtime zyrtare	3,558.00
8	Avancet e hapura	2
9	Vlera e Avanse të pambyllura	2,494.29
10	Vlera e Avanseve te hapura(pc)	2,494.29
11	Vonesa e fakturave mbi 30 ditë	0
12	Lëndet e kthyer	5
13	Rimbushje	0

Siç shihet edhe nga tabela e më sipërme, ku janë dhënë shpenzimet për periudhën Korrik-22 Dhjetor 2023 sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, për kategoritë e shpenzimeve: **Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Subvencione dhe Transfera dhe Investime Kapitale** shuma totale e shpenzimeve është 2,053,144.70.

Pjesë përbërse e zyrës së Thesarit është edhe Arkiva në të cilën arkivohen lëndet e procesuara, sipas udhëzimeve për arkivim nga MF, të renditura dhe të azhuruara në bazë të numrave të kuponave të shpenzimit.

Objektivë parësore e Zyrës së Thesarit është të bëjë një reformim të brendshëm, me synimin që të thjeshtësohen procedurat duke kursyer kohën dhe shpenzimet e pa nevojshme, të cilat krijohen pa arsye, dhe të ketë një efikasitet dhe azhuritë në nivelin e duhur konform rregullativave me të cilat kryejmë aktivitetet tona.

Implementimi i rekomandimeve eventuale nga Zyra Kombtare e Auditimit dhe Auditorit të mbrendëshëm gjatë procesimit të pagesave, me fokus të veçant shpenzimi i paras publike me parimet më të mira të menaxhimit financiar.

Pagesa e faturave brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, për të mbajtur në kontroll buxhetin dhe vlerën e borxheve ndaj operatoëve ekonomik.

Klasifikimin ekonomik të shpenzimeve në kodet adekuate për të mundësuar një paraqitje reale të shpenzimeve në pajtim me planin kontabël për vitin 2023.

Kontrollimi i mos tejkalimit të kontratave dhe specifikimeve teknike për të mundësuar realizimin e kushteve të kontratave valide që komuna ka të lidhura me operatorët ekonomik.

Verifikimi nëse përfituesit e subvencioneve kanë sjellur raportet financiare dhe narrative sipas marrëveshjes dhe rregulloreve për fushën e subvencioneve, si përfituese të projekteve nga Komuna. Hapja, kontrollimi, rimbushja, shpenzimi dhe mbyllja e avanseve për para të gatshme dhe avanseve për udhëtime zyrtare.

Pëmbledhja

Në fund do të bëjmë një pëmbledhje të shkurtës edhe të planifikimit të buxhetit për vitin 2024.

Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 4, 5 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ(MAPL) NR. 06/2018 Për Standardet Minimale Të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenit 20 nenit të Statutit të Kamenicës 01.Nr.20203 dt.21.06.2023, Drejtoria për Financa dhe Buxhet së bashku me Zyrën e Kryetarit ka organizuar dëgjime buxhetore.

Janë mbajtur gjithësejt 28 dëgjime buxhetore me 663 pjesëmarrës, prej tyre 127 femra dhe 536 meshkuj pjesëmarrës në të gjitha vendet ku janë mbajtur dëgjimet.

Fillimisht Kryetari i Komunës, Kadri Rahimaj ka realizuar një video të shkurtër, ku flet për rëndësinë e pjesëmarrjes së banorëve të Kamenicës në hartimin e Draft-Buxhetit duke prezantuar projektet, propozimet e tyre duke marr pjesë në Dëgjimet Buxhetore. Kryetari Rahimaj në këtë video theksoi se kjo praktikë është ndjekur edhe vitin e kaluar ku buxheti është hartuar me të gjitha propozimet e qytetarëve në vendet ku ata banojnë.

Më pas Kalendari i Dëgjimeve për Buxhetin është publikuar në Ëeb-faqen e Komunës së Kamenicës dhe në Faqen Zyrtare në Facebook një javë para fillimit të mbajtjes së dëgjimeve.

Po ashtu çdo ditë para se të mbahej Dëgjimi Buxhetor i paraparë në Kalendarin e Dëgjimeve është publikuar një njoftim i shkurtër se ku do të mbahej dëgjimi dhe ora e mbajtjes.

Gjatë mbajtjes së Dëgjimeve Buxhetore, i pranishëm ka qenë Grupi Punues për organizimin e dëgjimeve. Kryesuesja e Grupit e ka paraqitur Draft-Buxhetin, ku më pas Kryetari para banorëve të pranishëm ka paraqitur projektet e realizuara në vitin e kaluar për lokalitetin ku është mbajtur dëgjimi. Pas përfundimit të prezantimit nga Kryetari, banorët kanë pasur mundësinë që të paraqesin kërkesat/propozimet e tyre për lokalitetin ku ata jetojnë, në mënyrë që ato të cilat janë më prioritare të përfshihen në Draft-Buxhet. Nga të gjitha lokalitetet ku janë mbajtur dëgjimet buxhetore është mbajtur procesverbal dhe listë e nënshkrimeve e të pranishmëve, ku më pas këto procesverbale dhe lista janë publikuar në Ëeb-faqen e Komunës si dhe në Platformen e Qeverisë për Konsultimet Publike. Në fund të procesit të dëgjimeve buxhetore kemi përgatitur edhe raportin e dëgjimeve ku kemi arsyetuar çdo kërkesë të propozuar nga qytetarët dhe e kemi paraqitur në faqen e komunës.

Më poshtë kemi paraqitur edhe tabelat me numrin e pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore:

I.Informatë për Konsultimet/Dëgjimet buxhetore e organizuara dhe kërkesat e qytetarëve për 2024

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i takimit/tubimit publik</i>	<i>Nr. Tubimeve</i>	<i>Nr. Pjesëmarrësve, M/F</i>	<i>Numri i kërkesave</i>
<i>1</i>	<i>Konsultimi publik për KAB-in</i>	<i>1</i>	<i>15 M +10 F=25</i>	<i>0</i>
<i>2</i>	<i>Dëgjimet buxhetore</i>	<i>28</i>	<i>536 M+127 F=663</i>	<i>342</i>
<i>3</i>	<i>Gjithsejtë</i>			

II. Kërkesat/projektet e përfshira në planin buxhetor për vitin 2024

<i>Nr.</i>	<i>Tubimet publike</i>	<i>Nr. Kërkesave</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Pjesërisht/Pra</i>	<i>Pa pranuar</i>
<i>1</i>	<i>Konsultimet publike- KAB</i>	<i>Nuk ka pasur</i>	<i>/</i>	<i>/</i>	<i>/</i>
<i>2</i>	<i>Dëgjimet buxhetore</i>	<i>28</i>	<i>188</i>	<i>18</i>	<i>147</i>
<i>3</i>	<i>Gjithsejtë</i>				

III. Kërkesat/Projektet e grupeve të nën përfaqësuar/Margjinalizuara

<i>Nr.</i>	<i>Tubimet me Grupe</i>	<i>Nr. Tubimet</i>	<i>Nr. Kërkesave</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Pjesërisht/Pra</i>	<i>Pa pranuar</i>
<i>1</i>	<i>Grupi i Grave</i>	<i>3</i>	<i>28</i>	<i>20</i>	<i>1</i>	<i>7</i>
<i>2</i>	<i>Grupet e të Rinjve</i>	<i>1</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>3</i>	<i>Komuniteti pakicë</i>	<i>1</i>	<i>5</i>	<i>3</i>	<i>0</i>	<i>2</i>
<i>4</i>	<i>Fermerët</i>	<i>1</i>	<i>7</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>2</i>
<i>5</i>	<i>Stafi Mjekësor</i>	<i>1</i>	<i>5</i>	<i>3</i>	<i>0</i>	<i>2</i>
<i>6</i>	<i>Mësimdhënësit</i>	<i>1</i>	<i>35</i>	<i>20</i>	<i>3</i>	<i>12</i>
<i>7</i>	<i>Qytetarë me profile të ndryshme</i>	<i>1</i>	<i>270</i>	<i>140</i>	<i>11</i>	<i>122</i>

Komuna e Kamenicës, për vitin 2024 ka një rritje të buxhetit duke krahasuar me vitin 2023 (2,141,918.00€) apo shprehur për 17,.30%.

Organizata jonë buxhetore (653) ka zhvilluar procesin e hartimit të draft-buxhetit për vitet 2024-2026, në harmoni të plotë me instruksionet e pranuar nga Ministria e Financave përmes qarkoreve buxhetore, si dhe në zbatim të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi të jetë në përputhje me interesat e përgjithshme të qytetarëve të komunës, në përputhje me kufijtë e limituar të financimit.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, AMBIENTIT DHE INSPEKTORATIT:

Drejtoria e Shërbime Publike, Ambientit dhe Inspektoratit konform Ligjeve dhe Akteve tjera nënligjore, Rregulloreve Komunale dhe Vendimit për Organizimin, si dhe duke u bazuar në Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorive të Administratës Komunale i ka kryer obligimet dhe detyrat e veta. Kjo drejtori në kuadër të saj i ka 3 (tre) sektorë.

- Sektori i Shërbimeve Publike;
- Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit; dhe
- Sektori i Inspektoratit.

1. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE (SHP) DHE SEKTORI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE, DHE AMBIENTIT (MMA)

❖ Stafi

- Udhëheqës i sektorit të SHP, 1
- Udhëheqës i sektorit për MMA, 1
- Zyrtar i ambientit, 1
- Zyrtar për KEK dhe PTK, 1
- Zyrtar administrativ, 1
- Mirëmbajtës të ambientit, 2

Pas përfundimit të kontratës për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe gjelbëruese në qytet, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, i kemi pranuar edhe tre punëtorë tjerë me kontrata për shërbime të veçanta për mirëmbajtjen e hapësirave publike në qytet. Gjithashtu përveç këtyre e kemi edhe një zyrtar tjetër për dhënien e dëftesave për regjistrimin e automjeteve.

❖ **Projektet në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizime, infrastrukturë dhe të tjera**

- **Ndërtimi i sistemit të ujit të pijes në fshatrat, Muqiverc, Rogaqicë, Novo Sellë, Hodonoc, Petroc, dhe Dajkoc.** Projekti ka vlerën 70,000.00€, punët kanë përfunduar.
- **Ndërtimi i puseve për ujë të pijes në Kamenicë,** Projekti ka vlerën 40,000.00€, dhe punët kanë përfunduar.
- **Ndërtimi i pritoreve të autobusëvenë Hogosht, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc, Topanicë dhe Koretin.** Projekti ka vlerën 50,000.00€, punët janë në fazën e realizimit dhe akoma nuk kanë përfunduar.
- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, Karaqevë, Rogaqicë, Kopernicë, Koretin, Hogosht, Hodonoc, Strezoc.** Vlera e projektit 50,000.00€ dhe punët janë duke u zhvilluar.
- **Ndërtimi i kanalizimit fekal në Kamenicë, Karaqevë, Busavatë, Kopernicë, Koretin dhe Topanicë.** Projekti ka vlerën e planifikuar 170,000.00€, dhe punimet janë duke u zhvilluar.
- **Ndërtimi i çeshmeve për ujë të pijes në bulevardin e qytetit dhe brenda institucioneve publike.** Vlera e projektit është 8,000.00€, punimet akoma nuk kanë përfunduar.
- **Ndërtimi i sistemit të ujitjes në parkun e qytetit.** Projekti ka vlerën 30,000.00€ dhe punët kanë përfunduar.
- **Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe infrastrukturës komunale,** vlera 80,000.00€.
- **Furnizimi me shporta 50 litra në qytet dhe institucione shkollore në lokalitete të ndryshme,** Projekti është në procedurat e prokurimit.
- **Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik.** Vlera e projektit është 35,000.00€, ku janë shpenzuar rreth $\frac{3}{4}$ e mjeteve.

Në tabelën e mëposhtme do t'i paraqesim në tërësi rrjeti e ndriçimit publik sipas lokaliteteve.

Tabela Nr. 1; Ndriçimi publik në territorin e Komunës së Kamenicës, sipas lokaliteteve

Nr.	Shtrirja e rrjetit të Ndriçimit publik sipas lokaliteteve		
	Lokalitetet	Trupa ndriçues në (copë)	Gjatësia e rrjetit në (m)
1	Berivojcë	109	4360
2	Boscë	35	1400
3	Busavatë	66	2640
4	Dajkoc	44	1760
5	Hajnoc	42	1680
6	Hodonoc	227	9080
7	Hogosht	157	6280

8	Kamenicë	849	33960
9	Karaqevë e Epërme	130	5200
10	Karaqevë e Poshtme	182	7280
11	Kolloleq	21	840
12	Kopernicë	88	3520
13	Koretin	284	11360
14	Krilevë	34	1360
15	Moçar	19	760
16	Muçiverc	221	8840
17	Novosellë	25	1000
18	Petroc	89	3560
19	Rogaçicë	265	10600
20	Ruboc	82	3280

21	Strezoc	67	2680
21	Shipashnicë e Epërme	99	3960
22	Shipashnicë e Poshtme	61	2440
23	Topanicë	266	10640
T O T A L I		3462 trupa	138,480.00 m

❖ **Mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve lokale**

Kontrata e ka vlerën 100,000.00€, ku nga këto mjete 15,000.00€ janë të planifikuara për rregullimin e sinjalizimit vertikal dhe horizontal, ndërsa shuma prej 85,000.00 € janë të planifikuara për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore, si dhe shtruarjen e rrugëve me zhavorr. Sinjalizimi ka përfunduar në tërësi ndërsa shuma tjetër e mbetur prej rreth 40% e mjeteve do të realizohet për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale. Në vendosjen e sinjalizimit vertikal dhe horizontal ju kemi dhënë prioritet kërkesave ku ka pasur frekuentim më të madhe të qytetarëve, pasi nuk ka pasur mundësi të realizohen të gjitha kërkesat dhe nevojat për vendosjen e sinjalizimit.

❖ **Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra publike**

Duke pasur parasysh se kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra ka përfunduar, ne përmes punëtorëve të ambientit si dhe tre punëtorëve të cilët i kemi pranuar me shërbime të veçanta për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, i kemi kryer të gjitha punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtje të hapësirave të gjelbra. Sipërfaqen e tyre do ta paraqesim në tabelën Nr. 2.

Tabela Nr. 2; Hapësirat e gjelbra publike

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja (m ²)
1	Mirëmbajtja intensive e hapësirave gjelbëruese	67,493
2	Varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët	31,886
Sipërfaqja e përgjithshme (m²)		99,379

Përveç hapësirave të cekura më lartë, DSHPAI mirëmban edhe hapësira të tjera publike të cilat nuk janë të shënuara në këtë tabelë mirëpo sipas nevojës edhe ato mirëmbahen nga punëtorët për mirëmbajtjen e ambientit, të cilët vazhdimisht sipas nevojës bëjnë edhe pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave nëpër lokalitete të ndryshme.

❖ Projektet dhe fushatat e pastrimit të mjedisit

Në periudhën e dytë të këtij viti janë planifikuar disa aksione për pastrimin e ambientit, ku sipas planifikimit edhe janë realizuar si në vijim:

- **Me 16 shtator në kuadër të aksionit “Ta pastrojmë Kosovën” është organizuar aksioni “Ta pastrojmë Kamenicën”.** Aksioni është mbajtur në të gjitha lokalitetet e komunës duke u pastruar hapësirat për rreth objekteve publike, shkollave dhe institucioneve tjera. Është bërë edhe pastrimi i deponive ilegale në disa lokalitete (në Topanicë, në Hogosht, në Grizime, në Katushnicë në afërsi të urës, si dhe disa vende në qytet ku janë eliminuar disa deponi të vogla). Në këtë aksion kanë marrë pjesë edhe KL, grupe vullnetarësh të rinj nga KL, KVRL, DSHPAI, kompani të cilat mirën me seperimin e zhavorrit etj.
- Po ashtu nga punëtorët e mirëmbajtjes ka pasur pastrime të përditshme të ambientit në pjesën e qytetit, te pishat, te varrezat në lagjen Malësia, dhe disa vende tjera.

❖ **Transporti lokal, linjat urbane dhe urbane-periferike, dhënia e lejeve për Taxi**

Në këtë periudhë të vitit nga muaji Korrik kemi dhënë vetëm rendin e udhëtimit për operatorët transportues të cilët bëjnë bartjen e nxënësve ndërsa të tjerat janë dhënë në muajt paraprak. Ndërsa pas aprovimit të rregullores së re për taksa, tarifa dhe gjoba komunale ushtrimi i veprimtarisë për operatorët e Taksive është pa pagesë, andaj edhe nuk kemi pasur të hyra nga kjo fushë. Në tabelën në vijim do ti paraqesim të dhënat për secilin muaj:

Tabela nr. 3; Të hyrat nga harmonizimi i vijave për periudhën Korrik-Dhjetor.

Nr.	Numri i vijave të lëshuara dhe rendi i udhëtimit		Pagesa e rendit të udhëtimit në €
	Muaji	Numri i OT	
1	Korrik	/	/
2	Gusht	1	22.00
3	Shtator	1	12.00
4	Tetor	3	55.00
5	Nëntor	/	/
6	Dhjetor	/	/
	TOTALI	5	89.00 €

❖ **Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve**

Të hyrat nga regjistrimi i veturave për periudhën Korrik – Dhjetor 2022 dhe 2023, janë paraqitur në tabelën Nr.4.

Tabela Nr. 4; Të hyrat nga regjistrimi i veturave (Korrik-Dhjetor 2022 dhe 2023)

Nr	Muaji	Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve (EUR)			
		2022		2023	
		Nr. i Automjeteve	Pagesa në (€)	Nr. i Automjeteve	Pagesa në (€)
1	Korrik	784	8,060.00	829	8,385.00
2	Gusht	696	7,240.00	774	7,905.00
3	Shtator	609	6,390.00	595	6,185.00
4	Tetor	599	6,130.00	695	7,050.00
5	Nëntor	602	6,190.00	608	6,130.00
6	Dhjetor	/	/	/	/

TOTALI	3290	34,010.00 €	3501	35,655.00
---------------	-------------	--------------------	-------------	------------------

Skjarim: Të hyrat për muajin Dhjetor nuk janë të llogaritura.

❖ **Dhënia e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave tjera publike më pak se një vit**

DSHPAI duke u bazuar në kompetencat e veta që ka, menaxhon me hapësirat publike duke dhënë pronën publike në shfrytëzim të përkohshëm më pak se një vit, ku të dhënat duken si në tabelën e më poshtme Nr. 5.

Tabela Nr. 5; Lejet për shfrytëzim të hapësirave publike (Korrik – Dhjetor 2022 dhe 2023)

Nr.	Muaji	2022		2023	
		Aplikacione	Të hyra në €	Aplikacione	Të hyra në €
1	Korrik	3	1,906.34	1	165.00
2	Gusht	1	/	1	118.80
3	Shtator	1	/	/	/
4	Tetor	1	55.00	/	/
5	Nëntor	1	1,600.00	/	/

6	Dhjetor	/	/	1	53.60
TOTALI		7	3,561.34 €	3	337.40 €

Skjarim: Të hyrat për muajin dhjetor nuk janë të llogaritura.

❖ **Të hyrat nga kiosqet dhe garazhet**

Në këtë periudhë, për kioska janë inkasuar **760.00 €**, ndërsa nuk ka pasur të hyra nga garazhet.

Nr.	Muaji	2023	
		Aplikacione	Të hyra në €
1	Korrik	1	7.50
2	Gusht	4	350.00
3	Shtator	1	20.00
4	Tetor	/	/

5	Nëntor	/	/
6	Dhjetor	1	20.00
TOTALI		7	397.50 €

❖ Të hyrat nga dhënia e lejeve për mbyllje të rrugëve dhe qarkullimin në rrugët ku është ndaluar lëvizja e automjeteve mbi 3,5 ton.

Tabela nr.6; Aplikimet dhe të hzrat në infrastrukturë

❖ **Të hyrat nga Lejet Mjedisore komunale (LMK)**

Në periudhën Korrik – Dhjetor janë pranuar dhe trajtuar kërkesat sipas tabelës në vijim:

Nr.	Muaji	2023	
		Aplikacione	Të hyra në €
1	Korrik	1	50.00
2	Gusht	/	/
3	Shtator	1	50.00
4	Tetor	4	200.00

5	Nëntor	1	50.00
6	Dhjetor	/	/
TOTALI		7	350.00 €

Tabela nr. 7; Aplikimet dhe të hyrat për LMK

Skjarim: Muaji dhjetor nuk është llogaritur.

❖ **Të hyrat e përgjithshme**

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit për periudhën Korrik – Nëntor 2023, ka arritur të inkasoj të hyrat nga shërbimet e ndryshme, si në tabelën e mëposhtme.

Tabela Nr. 8; Të hyrat nga shërbimet e DSHPAI për periudhën Korrik – Nëntor

Nr.	Pagesat sipas kategorive të caktuara	2023
1	Harmonizim i vijave	89.00
2	Taksat për regjistrimin e automjeteve	35,655.00
3	Shfrytëzimi i hapësirave publike	337.40
4	Leje Mjedisore Komunale (LMK)	350.00

5	Të hyra nga kioskat	760.00
6	Lejet për mbyllje të rrugëve dhe të tjera	397.50
Totali		37,588.90 €

Menaxhimi i shpenzimeve komunale: energjisë elektrike, ndriçimi publik, ujësjellës, mbeturina dhe telefoni fikse

Drejtorja e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit ka menaxhuar harxhimet e shërbimeve komunale, të cilat për periudhën raportuese Korrik – Dhjetor 2023 , do ti paraqesim në tabelën Nr.9

Tabela Nr. 9; Shpenzimet komunale (Korrik - Dhjetor 2023)

Muaji	Rryma Administrata	Ndriçimi Publik	Uji	Telefonia fikse	Mbeturinat	Totali
Korrik	2,242.92	6,000.27	862.03	149.60	179.40	9,434.22
Gusht	2,282.22	6,789.20	385.09	132.28	179.40	9,768.19

Shtator	1,825.77	8,067.39	112.34	122.88	179.40	10,307.78
Tetor	2,639.44	8,952.91	148.13	132.02	179.40	12,051.90
Nëntor	3,926.36	10,604.35	180.91	144.10	179.40	15,035.12
Dhjetor	/	/	/	/	/	/
Totali	12,912.71	40,414.12	1,688.50	680.88	897.00	56,597.21

❖ **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga Ndërmarrja “Ecohigjiena”. Në kuadër të realizimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave kemi vazhduar zgjerimin e rrjetit duke i furnizuar qytetarët me kontejner 120 L, ku secili qytetar pas pranimit të kontejnerit ka nënshkruar kontratë me kompaninë Ecohigjiena, e cila e bën grumbullimin e mbeturinave, kemi pasur një koordinim dhe bashkëpunim me kryetaret e KL, të cilët na kanë përkrahur si në finalizimin e listave ashtu edhe në organizimin e takimeve me KL, ku qytetarët janë njoftuar me PKMM, dhe Rregulloren për MM. Në këtë periudhë deri në dhjetor janë bërë edhe 340 regjistrime të reja, prej tyre 305 janë ekonomi familjare dhe 35 biznese, të cilat janë furnizuar me kontejner familjar dhe kanë nënshkruar kontratën me ecohigjienën për marrjen e mbeturinave. Zgjerimi i rrjetit është bërë në Hogosht, Muqiverc, Karaqevë e Poshtme, Bllatë dhe Dajkoc (në këto lokalitete zgjerimi i rrjetit të mbeturinave ka arritur në 100 %, ndërsa në Rogaqicë dhe disa lokalitete tjera është duke u punuar që po ashtu të kemi një përfshirje më të madhe.

❖ **Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza**

Në lidhje me furnizimin me ujë të pijes për qytetarët e Komunës, DSHPAI ka pasur një mori aktivitetesh me KRU ”Hidromorava”, me qëllim që qytetarëve tu ofrohet furnizim kualitativ me ujë të pijes.

Aktualisht, KRU. “Hidromorava”, bënë furnizimin me ujë të pijes në lokalitetet e poshtëshënuara në tabelën Nr. 10;

Tabela Nr. 10; Lokalitetet e furnizuara me ujë nga KRU. “Hidromorava”

Nr.	Lokaliteti
1	Kamenicë
2	Berivojcë
3	Ruboc
4	Koretin
5	Topanicë
6	Kopernicë
7	Kolloleq
8	Shipashnicë e Epërme

9	Karaçevë e Poshtme

Në vazhdim do të paraqesim tabelat në lidhje me ecurinë e furnizimit dhe inkasimit të ujit për secilin lokalitet.

Tab. Nr.11; Ujësjetësi në Topanicë

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %
KORRIK	11560	6180	2903.12	2760.5	46.54	95.09
GUSHT	9280	7535	3462.9	4311.14	18.80	124.50
SHTATOR	7140	5147	2526.07	2810.95	27.91	111.28
TETOR	6180	5165	2583.91	2418.19	16.42	93.59
NËNTOR	5280	4055	2094.85	2465.5	23.20	117.69

DHJETOR	/	/	/	/	/	/
Totali:	39440	28082	13570.85	14766.28	/	/

**Tab. Nr.12; Ujësjetllësi në Fshatin
Krajevë e Poshtme**

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %
KORRIK	5709	1153	906.73	1517.56	79.80	167.37
GUSHT	1703	1633	866.98	855.66	4.11	98.69
SHTATOR	3592	1054	629.46	825.97	70.66	131.22
TETOR	5441	943	584.7	501.57	82.67	85.78
NËNTOR	4193	912	573.69	520.44	78.25	90.72
DHJETOR	/	/	/	/	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali:	20638	5695	3561.56	4221.20	/	/

Tab. Nr.13; Ujësjetësi në Kopernicë dhe Kollolëq

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %
KORRIK	2020	1510	914.06	927.73	25.25	101.50
GUSHT	2810	2525	1297.73	1490.48	10.14	114.85
SHTATOR	2250	2004	1104.6	746.46	10.93	67.58
TETOR	2430	2069	1151.45	889.45	14.86	77.25
NËNTOR	1070	611	565.27	781.15	42.90	138.19
DHJETOR	/	/	/	/	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali:	10580	8719	5033.11	4835.27	/	/

**Tab.Nr.14; Ujësjetësi
Koretin**

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %
KORRIK	8100	3126	1746.79	1506.77	61.41	86.26
GUSHT	7850	3999	2050.64	2132.31	49.06	103.98
SHTATOR	6690	3376	1773.08	1442.46	49.54	81.35
TETOR	6962	2766	1491.94	1436.21	60.27	96.26
NËNTOR	5437	1938	1170.91	1267.56	64.36	108.25
DHJETOR	/	/	/	/	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali:	35039	15205	8233.36	7785.31	/	/

Tab. Nr.15; Ujësjiellësi në Shipashnicë e Epërme

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në (%)	Inkasimi në %
-------	---------------	---------------	--------------	--------------	-----------------------	---------------

KORRIK	1950	1497	904.18	1329.74	23.23	147.07
GUSHT	6190	3409	1592.3	1152.66	44.93	72.39
SHTATOR	3820	2270	1173.19	871.19	40.58	74.26
TETOR	3780	2667	1318.07	973.86	29.44	73.89
NËNTOR	2930	1555	900.92	859.91	46.93	95.45
DHJETOR	/	/	/	/	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali:	18670	11398	5888.56	5187.36	/	/

Tab. Nr.16; Ujësjiellësi në Qytetin e Kamenicës

Muaji	Prodhimi (m³)	Faturimi (m³)	Faturimi (€)	Inkasimi (€)	Humbjet e Ujit në %	Inkasimi në %
KORRIK	53787	28516	17099.39	16682.69	46.98	97.56
GUSHT	54270	31858	18590.09	19737.13	41.30	106.17

SHTATOR	49125	29942	17770.75	16480.89	39.05	92.74
TETOR	53556	30474.5	17671.98	16336.27	43.10	92.44
NËNTOR	43304	22562.5	14178.51	14919.27	47.90	105.22
DHJETOR	/	/	/	/	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali:	254042	143353	85310.72	84156.25	/	/

➤ **Kërkesat e qytetarëve**

DSHPAI – ka pranuar kërkesa nga qytetarët, ku duke u bazuar në ligjet aplikueshme, aktet tjera nënligjore, rregulloret komunale dhe vendimet mbi kompetencat e drejtorive të administratës komunale dhe ka kryer obligimet si më poshtë :

Tabela Nr. 17; Aktivitetet e DSHPAI sipas kërkesave të qytetarëve

Nr.	Aktiviteti	2023
1	Kërkesa të pranuar	158

2	Kërkesa me përgjigje pozitive	72
3	Kërkesa me përgjigje negative	40
4	Kërkesa të bartura në institucione tjera	36
5	Kërkesa në procedurë	10

Skjarim, Kërkesat janë vetëm për periudhën Korrik - Nëntor

Përveç kërkesave të shkruara dhe të protokolluara, drejtoria ka punuar edhe kërkesa tjera përmes emailit si dhe gjatë takimeve që kemi pasur në forma të ndryshme, nga këshillat lokale, shkollat, kuvendi Komunal, policia e Kosovës, dhe institucione tjera Komunale dhe qendrore.

2. SEKTORI I INSPEKTORIATIT

Stafi i sektorit të Inspektoratit:

- Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit, 1
 - Inspektor i tregut, 2
 - Inspektor i mbrojtjes së mjedisit, 1

- Inspektor i ndërtimit, 1
- Zyrtar juridik, 1

Inspektimet në fushën e tregut

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit të Tregut si dhe inspektimet tjera grupore për periudhen në fjalë.

Lloji i veprimtarisë	Periudha gjashtë mujore 01.07.2023 deri 13.12.2023	Shuma në € te paguara
Inspektime në lëmin e tregtisë (të fushës)	159	
Kërkesë për dalje në teren të lokaleve për zhvillimin e veprimtarisë	23x20€	460 €
Pozitiv	21	
Pëlqime – Aktvendime	21	
Kërkesa për kundërvajtje Gjykatë	/	
Gjoba mandatore dhe administrative me Aktvendim	7 gjoba 1500 €.	1500x 50%=

	2 gjoba 200€=400 € janë në procedur. Totali = 1900 € 9 gjoba mandatore.	750 € të paguara.
Kallxim penal – Deklarat	/	
Ankesa per mbrojtje te Konsumatoreve	/	
Aktvendim – i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë dhe ndërtimtarisë.	1	
Urdhëresë për regjistrim të subjektit afarist	14	
Procesverbal për Auto Taxi	14	

Pjesa më e madhe e inspektimeve grupore kanë të bejnë në lidhje me inspektime te fushës, lëmin e ndërtimit, qështjeve ambientale,të tregëtisë si dhe shqyrtimin e ankesave të ndryshme të qytetarëve.

Kam punë shtesë të pozitës së punës: Inspektor i komunikacionit Sh.02 Nr.38266 të datës;14.11.2023.

Inspektime në fushën e Ndërtimit

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit të Ndërtimtarisë, si dhe inspektimet tjera grupore për 6 mujorin Korrik-Dhjetor 2023:

Lloji i veprimtarisë	Periudha kohore Korrik-Dhjetor 2023	Shuma në € të paguara
Inspektime të Fushës Ndërtim	52	
Inspektime grupore me Inspektorët Komunal	160	
Pëlqime	0	
Procesverbale	7	
Vendime		
Gjoha mandatore dhe administrative	6	
Vlera e mjeteve nga këto gjoha		2800 €
Fletëparaqitje te përmbaruesi privat		
Kërkesa të shqyrtuara	9	

Pjesa më e madhe e inspektimeve grupore kanë të bëjnë në lidhje me inspektime te fushës, Ndërtimit shfrytzimin e hapsirave publike, qështjeve ambientale si dhe shqyrtimin e ankesave të ndryshme të qytetarëve etj.

Inspektimet në fushën e mjedisit

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me inspektimet në fushën e Inspektorit të Mjedisit, si dhe inspektimet tjera grupore për 6 mujorin e dytë Korrik-Dhjetor–2023:

Lloji i veprimtarisë	Periudha kohore Korrik-Dhjetor – 2023	Shuma në € te paguara
Inspektime ne fushën e mjedisit	77	
Inspektime grupore me Inspektorët Komunal – Ndertimit,Tregut etj.	76	
Procesverbale	69	
Vendime-Aktvendime	04	
Gjoba mandatore dhe administrative	16	
Vlera e mjeteve nga këto gjoba	3340 Euro	1670
Fletëparaqitje te përmbaruesi privat	02	
Kërkesa të shqyrtuara	35	

Urdheresa per pajisje me Leje per shfrytëzimin e Hapsires Publike .Nga Muaji-Tetor ne Procedurë	7	
Kërkesa të Shqyrtuara	36	

Pjesa më e madhe e inspektimeve kanë të bëjnë me zbatimin e masave në bazë të Rregulloreve Komunale në bashkëpunim me inspektorin e Ndërtimit, Tregut, etj.

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL:

Raporti i punës për gjashtëmujorin e dytë, ka të bëjë me përshkrimin e të gjitha punëve në tërësi që janë kryer që nga muaji Korrik deri në fund të muajit Dhjetor në DBPZHR.

Raportin e dytë gjashtëmujor e kemi filluar me vizitë në teren nga komisioni komunal për Inventarizimin e tokave bujqësore, pastaj me sesion informues, kontrollimin teknik të autokombajnave nga komisioni për Korrije-Shirje, hapjen zyrtare të fushatës së Korrije – Shirjeve, trajnime për fermer në teren. Pastaj përfundimi i disa projekteve për fermer nga Komuna – DBPZHR. vlerësime të dëmeve në teren, vizita në teren , kryerja e akteve administrative, punët e kryera në sektorin e Pylltarisë, etj.

1.1. Vizita në teren nga komisioni komunal;

Më datë 04.07.2023, komisioni komunal i caktuar për projektin „ **Inventarizimi i Tokave në K. e Kamenicës**”, kemi dalur në teren për të vizituar grupin punues për marrjen e mostrave të dheut për studimin fushor për hapjen e profileve të tokës, që i ka kryer punët OE. Geo&Land.

1.2. Mbajtja e sesioneve informuese;

Më datë 05.07.2023, kemi mbajtur sesionin informues me fermer të organizuar nga DBPZHR.në bashkëpunim me Bankën Botërore – me organizatën FLOËS, për programin e granteve të vogla, që ka qenë projekt i Qeverisë së Kosovës prezentuar nga Afrim Frokaj dhe financuar nga Kredia e Bankes Botërore.

Më datë 11.07.2023, kemi mbajtur sesionin informues me fermer të organizuar nga DBPZHR në bashkëpunim me „ikc” -ën, tema ka qenë „ Ndotja e ujërave nga aktivitetet bujqësore ”

Më 16.11.2023, DBPZHR. ka organizuar një takim me fermerët e komunës prodhues të qumështit për litër nga sektori i blegtorisë, që përkrahet nga Kryetari i Komunës për çdo 6 Mujor që është edhe premtim i kryetarit. Përkrahja e fermerëve prodhues të qumështit për litër bëhet nga 0.05 cent për litër dhe në këtë takim kanë marr pjesë, zyra e kryetarit, Shefi i kabinetit.

1.3. Kontrollimi teknik i autokombajnave nga komisioni për Korrje–Shirjeve;

Më datë **11, 12 dhe 13.07.2023**, komisioni i caktuar nga Kryetari për fushatën e Korrje-shirjeve, e ka filluar punën me dalje në teren për të bërë kontrollimin teknik të autokombajnave, pastaj ju kemi dorëzuar kombajnerëve procesverbalet si dhe njoftimin për çmimin e caktuar nga MBPZHR. Të gjithë Kombajnerët janë informuar për obligimet që duhet ti ndërmarrin për parandalimet e zjarreve që paraqiten gjatë procesit të korrje-shirjeve.

1.4. Hapja zyrtare e fushatës së Korrje – shirjeve;

Për çdo vit DBPZHR. organizon dhe përcjell fushatën e Korrje – shirjeve në komunën tonë, kështu që në Komunën e Kamenicës, procesi i korrje-shirjeve ka filluar më datë 11.07.2023, duke filluar me korrjen e parcelave të mbjella me kulturën e Elbit, pastaj më datë 14.07.2023 ka filluar edhe korrje – shirja e sipërfaqeve të mbjella me kulturën e Grurit.

Më datë 18.07.2023 është bërë hapja zyrtare e fushatës së korrje-shirjeve në komunën tonë dhe ka përfunduar procesi i korrje – shirjeve më datë 15.08.2023. Sipërfaqet për korrje për këtë vit kanë qenë me sa vijon : Grurë 2,100 ha., Elb 50 ha., Tërshërë 180 ha. dhe 40 ha. dhe me Trotikal 40 ha. Rendimenti mesatar për këtë vit ka qenë me sa vijon: Te Gruri ka qenë 2,800 kg./ha. kurse te Elbi ka qenë 2,500 kg./ha. dhe gjithë sipërfaqet e korrur me këto kultura i takojnë sektorit privat.

Gjatë procesit të Korrje-shirjeve këtë vit në komunën tonë, kanë qenë të përfshirë 34 Autokombajna.

1.5. Përcjellja e procesit të Korrje-shirjeve nga komisioni;

Gjatë tërë procesit të Korrje-shirjeve, që nga fillimi e deri në përfundimin e saj, komisioni ka bërë përcjelljen e saj duke dalë në teren. Komisioni ka bërë përcjelljen e kombajnave në teren duke kontrolluar që të mos bëjnë derdhjen e drithërave në tokë, respektimin e ngastrave të fermerëve e kështu me radhë.

1.6. Informatat për zyrën e Kryetarit, zyrën e informimit dhe MBPZHR. për fushatën e Korrje Shirjeve;

Pas fillimit të fushatës së korrje-shirjeve në komunën tonë, komisioni ka bërë disa informata për të informuar Ministrinë e bujqësisë, Kryetarin e Komunës, zyrën e informimit, për procesin e fushatës së korrje – shirjeve.

Më datë 20.07.2023, është bërë informata e parë nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit;

Më datë 25.07.2023, është bërë informata e dytë nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit dhe

Më datë 16.08.2023, është bërë informata përfundimtare për përfundimin e procesit të korrje- shirjeve nga komisioni dhe ju është dërguar Ministrisë së bujqësisë, Kryetarit të komunës dhe zyrës së informimit;

1.7. Faza e aplikimit për subvencionim të qumështit dhe therreve të viçave – Pagesa - Direkte / Subvencione -MBPZHR.;

Afatin e aplikimit për subvencionim të qumështit për litër nga MBPZHR. / AZHB – ja, e kemi pasur që nga data 10.07.2023 dhe ka zgjatur deri më datë 18.08.2023, 6M- 1 /2023.

Subvencionimi i qumështit bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të Licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontrata me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë edhe atë sipas kategorive që po i japim më poshtë :

1. Ekstra Klasë - 0.07 €./ litër.
2. Klasa e parë – 0.04 €./ litër.
3. Klasa e dytë – 0.02 €./ litër.

Kriter për aplikim për qumësht, është që fermeri të ketë të dorëzuar për gjashtë muaj minimum 3,000 litra qumësht në pikat grumbulluese. Më poshtë në formë tabelore po i paraqesim :

Nr.	Emërtimi	Nr. aplikuesve	Sasia e dorëzuar e qumështit/ lit.- 6M-1./ krerë
1	Qumësht për/ lit.	50	729,671 / litra

2	Majmeri te viçave	2	45
3	Therrje të viçave	1	18 / krerë

1.8. Mbajtja e temave trajnuese nga DBPZHR.;

Gjatë këtij gjashtë mujori të dytë, kemi mbajtur disa tema trajnuese dhe këshilluese për fermerët e sektorëve të ndryshëm. Më datë 10.08.2023, kemi mbajtur temën trajnuese për fermerët bletar të komunës, edhe atë në fshatin Rogaçicë tek bletari Muhamet Kryeziu.

Më datë 29.09.2023, kemi mbajtur temën trajnuese të radhës nga sektori i perimekulturës dhe pemëtarisë „ Përpunimi i perimeve ” dhe ishim tek fermerja M. Spahiu në fsh. Muçivercë dhe tek fermeri R. Selishta në fsh. Karaçevë e Po. që bën grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve në pikën grumbulluese që e ka në pronësi.

Më datë 24.10.2023, kemi mbajtur temën trajnuese të radhës nga sektori i perimekulturës ishim tek fermeri F. Sylaj në fsh. Kopernicë, trajtimi dhe ruajtja e perimeve në serra.

Më datë 25.10.2023, temën trajnuese të radhës nga sektori i shpezëtarisë e kemi mbajtur tek fermeri B. Vranja në fsh. Hogosht, që ka një fermë të pulave shtëpiake dhe është këshilluar rreth trajtimit dhe ruajtjes nga sëmundjet e ndryshme.

Më datë 25.10.2023, temën trajnuese të radhës nga sektori i blegtorisë e kemi mbajtur tek fermeri S. Thaqi në fsh. Muçivercë, që ka një fermë të deleve dhe i kemi dhënë disa këshilla rreth menaxhimit të fermës.

Po me këtë datë të lartë cekur kemi mbajtur temën trajnuese të radhës nga sektori i blegtorisë edhe tek fermeri A. Lenjani në fsh. Novosellë, që ka fermë të lopëve qumështore dhe është këshilluar rreth prodhimit të qumështit.

1.9. Projektet e realizuara nga DBPZHR./ Komuna;

- Drejtoria e bujqësisë këtë vit në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar këto projekte:
 - a) Subvencionim i fermerëve me Farë gruri dhe pleh artificial / vjeshtor;
 - b) „ Subvencionim i fermerëve për Qumësht / litër – 6M-1 / 2023;
 - c) „Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor” për: Pijatore me 24 disqe dhe Kositse bari rotative;
 - d) „Inventarizimi i Tokave në K.e Kamenicës” Projekt dy vjeçar – 2022/2023

Nr.	Emërtimi i projekteve të realizuara	Nr. i Aplikuesve	Nr.i Përfituesve	Shumat totale të projekteve në / €.
1	„ Subvencionim i fermerëve me Farë gruri dhe pleh artificial/ vjeshtor;	48	48	13,138.25 €.
2	„ Subvencionim i fermerëve prodhues të Qumësht / litër; - 6M – 1.	63	63	41,999.85 €.
3	„Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor”	87	20	22,490.00 €.
4	„Inventarizimi i Tokave në K.e Kamenicës” Projekt dy vjeçar – 2022/2023	0	0	299,225.00 €.
5	Inventarizimi i Tokave në K.e Kamenicës” Punët shtesë (Aneks – Kontrata)	0	0	29,556.25 €.
Gjithsej:		198/ Aplikues	131/ Përfitues	

- Projekti i „ **Inventarizimit të tokave në K. e Kamenicës** ”, ka qenë projekt dy vjeçar 2022/2023, kurse këtë e kemi përmbyllur dhe përfunduar këtë projekt nga OE. GEO& LAND SH.P.K. dhe të gjitha raportet e punimeve të kryera.
Për këto projekte kemi disa foto të bëra që po i paraqesim ndaras:

❖ **„Inventarizimi i Tokave në K. e Kamenicës” ;**

Më datë 28.09.2023, komisioni komunal i projektit i ka vizituar zyret punuese të OE. Geo&Land në Prishtinë, si dhe laboratorin për bërjen e analizave të dheut të mara nga tereni nga hapjet e profileve. Të gjitha punët ne si komision i kemi par së afërmi se si i kryente OE. kemi edhe disa foto të bëra:

❖ **Dorëzimi i Raportit përfundimtar të punëve të kryera nga OE. Geo&Land;**

Më datë 30.11.2023, komisioni komunal ka pranuar raportin përfundimtar të punëve të kryera nga OE. dhe është bërë Dorëzim – Pranimit i këtij raporti, ku ne po i shkëpusim disa foto të dorëzimit;

❖ **Prezantimi i projektit nga përfaqësuesit e OE. Geo&Land;**

Më datë 04.12.2023, me kërkesë të OE. Geo&Land për të bërë prezantimin e projektit të Inventarizimit të Tokave në K. e Kamenicë, ne kemi organizuar dhe njoftuar zyrtarët komunal për të marrë pjesë në këtë prezantim siç ka qenë me interes edhe për disa drejtorë të komunë. Nga ky prezantim po i shpalosim edhe disa fotografi që i kemi bërë, shih si më poshtë:

2.0. Vlerësimet e dëmeve në teren;

Edhe këtë vit drejtoria e bujqësisë pas pranimit të kërkesave nga fermerët për vlerësime të dëmeve, komisionet e caktuara nga drejtoria kanë dalë në teren dhe kanë kryer vlerësimet e dëmeve në teren për sektorë të ndryshëm, përmes komisioneve të caktuara nga drejtoria.

Përmes tabelës po i paraqesim numrin e vlerësimeve të dëmeve sipas sektorëve:

Nr.	Sektorët	Nr. i vlerësimeve të dëmeve
1	Perimtari	1 vlerësime
2	Pemëtari	4 vlerësime
3	Lavërtari	1 vlerësime

2.2. Drejtoria e Bujqësisë deri më datë 15.12.2023, në vazhden e punëve ka kryer edhe këto punë për Korrik – Dhjetor, që po i paraqesim përmes tabelës si më poshtë:

Nr.	Emërtimet e aktiviteteve	Gjithsejtë nr. i tyre
1	<i>Plotësimi i bllokave uniref për pagesa</i>	<i>5 / fletëpagesa</i>
2	<i>Lëshuarja e certifikatave të NIF-it</i>	<i>16 / certifikata</i>
3	<i>Lëshuarja e vërtetimeve</i>	<i>9 / Vërtetime</i>

4	Kryerja e akteve administrative	142 /Akte administrative
5	Vlerësimi i dëmeve	6 / vlerësime
6	Leje për Korrije - shirje	34 /Leje
7	Numri i përfituesve nga projektet Komunale dhe nga organizatat e huaja	131 / përfitues

2.3. Të hyrat nga sektori i Bujqësisë për gjashtë mujorin e dytë:

Nr.	Të hyrat	Shuma në / €.
1	Korrik - Dhjetor	1,123.00 /€.

2.4. Në kuadër të Drejtorisë, edhe sektori i Pylltarisë i ka kryer punët prej 01.07.2023 – 01.12.2023. Korrik – Dhjetor, që po i paraqesim përmes tabelës:

Nr.	Emërtimet e aktiviteteve	Gjithsej
1	Kërkesa të parashtruara për prerje në Pyjet Private	12 / kërkesa
2	Kërkesa të shqyrtuara	305/ kërkesa
3	Masa drusore e realizuar dhe Transportuar nga pyjet private / Gjithsejt :	24,375.52 m ³
	- Dru Zjarri	22,679,12 m ³
	- Dru Teknik	1,696.40 m ³
4	Fletë dërgesa (Fletë përcjellëse) të dhëna	4,778 / copë.
5	Aktvendime gjyqësore / Gjithsejt :	20 / copë.
	- Kundër vajëse	12
	- Penale	8
6	Fletëparaqitje për Gjykatë të ngritura / Gjithsejt :	55 / copë.
	- Kundër vajëse	38 / copë.
	- Penale	17 / copë.
7	Masa drusore e konfiskuar / Gjithsejt :	41.10 / m ³
	- Dru Zjarri	41.10 / m ³

	- Dru Teknik	0.00 / m ³
8	Pyje Publike – Masa drusore e realizuar nga Tenderët / Gjithsejt :	45.00/ m ³
	- Dru Zjarri	36.00 / m ³
	- Dru Teknik	9.00 / m ³
9	Të hyrat në buxhetin e K. së Kamenicës 30 %. Nga Agjencioni Pyjor i Kosovës	43,618.65 / €.

2.4 Të hyrat nga sektori i Bujqësisë dhe Pylltarisë në gjashtë mujorin e dytë Korrik – Dhjetor :

Nr.	Korrik - Dhjetor / 2023	Sektorët	Shuma në €.
1	Korrik - Dhjetor	Spektori i Bujqësisë	1,123.00 €.
2	Korrik - Dhjetor	Spektori i Pylltarisë	43,618.65 / €.
	Gjithsej:		44,741,65 /€.

RAPORTI I PUNËS SË DREJTORISË PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM PËR PERIUDHËN KORRIK – DHJETOR 2023

Punët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë muajve Korrik-Dhjetor

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgaditjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e Komunës së Kamenicës dhe e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët vartës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas Planit të Punës për vitin 2023, në përputhshmëri me ligjin 04/L-027 “Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera”, udhëzimet administrative dhe rregulloret që janë në fuqi. Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer punët dhe detyrat e parapara me kohë dhe me sukses.

1. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur situatë emergjente për të cilat ka pasur nevojë aktivizimi i Shtabit Emergjent Komunal.
2. Kemi bërë hapjen dhe rrafshimin e rrugëve në pothuajse në tërë territorin e Komunës së Kamenicës me ngarkuesin CAT-966.

3. Gjatë kësaj kohe themi se ka pasur raste emergjente apo Fatkeqësi Natyrore, si vërshime të pjesshme që e kanë goditur Komunën e Kamenicës. Ajo që vlenë të theksohet është se nuk ka pasur lëndime të rënda dhe humbje jete të qytetarëve.
4. Stafi i drejtorisë menaxhon kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve lokale në sezonin veror – dimëror 2023;
5. Anëtare edhe e KKSBB (Kshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) si dhe shumë komisioneve dhe vendimeve të tjera nga Kryetari i Komunës;
6. Freskimi i Databaza-ve të kompanive që posedojnë makineri, në rast se na duhet ndihma e tyre në fatkeqësi të ndryshme, marrja e informative;
7. Pjesëmarrja e personelit në Menaxhimin e Kontratave nga ZKA;
8. Gatishmëria dhe menaxhimi i personelit të DMSH-së gjatë situatave emergjente;
9. Vijimi i trajnimeve profesionale të personelit të NjPZH;
10. Koordinim dhe përgatitje e Njesitit për Mbrojtje dhe Shpëtim për sezonin veror-dimëror (në pjesëmarrjen, vëzhgimin dhe shuarjen e zjarreve);
11. Inspektimin e rasteve emergjente si dhe hulumtimin e shkaktarëve të rreziqeve nga F.N-F.T.
12. Të gjitha këto janë aktivitete në të cilat është vënë në fokus Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, periudhë kjo e cila ka rezultuar të mos kemi asnjë rast me fatalitet në popullatë si dhe në ekipet reaguese

Spektori i Sigurisë dhe Planifikimit Emergjent

Spektori i Sigurisë dhe i Planifikimit Emergjent gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkaktarëve të rrezikut, evidentimin dhe parandalimin e tyre, si dhe hartimin e planeve relevante operative emergjente.

Spektori i Planifikimit Emergjent, gjatë kësaj periudhe ka kryer punët në:

1. Menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin si komisioni për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të sezonit dimëror - veror 2023;

2. Inspektimin e Rasteve Emergjente;
3. Menaxhimi i kontratës për Servisimin dhe Mirëmbajtjen e Automjeteve;
4. Anëtarë të Planit Zhvillimore Komunal-PZHK;
5. Përcjellje të punëve të terenit dhe punës së ngarkuesit, ku është intervenuar në zgjerimin dhe rrafshimin e rrugëve të dëmtuara pas të reshurave atmosferike. Poashtu është intervenuar në disa lokalitete, intervenime të lokalizuara emergjente, në bazë të kërkesave dhe rekomandimeve të sektorit.
6. Duke respektuar planin operativ të punës është bërë intervenimi në viset malore dhe rrugët e fshatrave, ku ka qenë e nevojshme;
7. Zyrtarët e DMSH-së janë aktiv në menaxhimin e disa kontratave si dhe antarë në komisione të ndryshme;
8. Menaxhimi i rasteve emergjente (vërshimeve, shembjeve të dheut);

Sektori për Informim dhe Alarmim

Që nga 28.06.2023 ky sektor nuk është funksional pasi që zyrtarja që ka qenë duke punuar është penzionuar dhe nuk është rekrutuar as një zyrtar për zëvendësimin e saj.

Megjithatë, edhe gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar të mbajmë kontaktet e vazhdueshme me qendrat e tjera të alarmimit në të gjitha Komunat e Kosovës.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet bilanci i drejtorisë, kërkesat, përgjigjet dhe vendimet.

Nga ky bilanc konkludojmë se të gjitha kërkesat po realizohen sipas planit të punës dhe planit operativ të DMSH-së.

Korrik – Dhjetor 2023

Statusi

Numri

1. Ne proces	28
2. Miratuar	29
3. Refuzuar	2
4. Pezulluar	1
5. Ceduar	1
Totali	61

Inspektimet nga Inspektori për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

Në bashkëpunim me stafin e DMSH-së dhe Inspektorin e Parandalimit janë realizuar këto detyra si: Inspektime të rregullta, Inspektime verifikuese dhe të jashtëzakonshme, evidentimi dhe vlerësime i dëmtimit të rrugëve nga faktori natyrë dhe njeri, urave, kanaleve të ujrave atmosferike, hidrantëve publike, shtreterve të lumenjëve si dhe rrëshqitjes së tokës aty ku mund të shkaktohet rrezikshmëri për mjedisin si dhe kemi ofruar kshilla pronarëve të subjekteve që posedojnë objekte të kategorive të ndryshme e që janë të renditura sipas shkallës së rrezikshmërisë.

Inspektimet kanë për qëllim konstatimin e gjendjes reale për ngritjen e masave të mbrojtjes nga F.N dhe F.T duke pasur parasysh masat e parandalimit dhe zvoglimit të numrit të fatkeqësive dhe pengimin ose zvoglimin apo parandalimin e mundshëm të viktimave dhe pasojave tjera.

Vlenë të theksohet se kemi realizuar një mori intervenime të lokalizuara si në infrastrukturën rrugore, kanalin e ujërave atmosferike ujë-lëshesave, hapjen dhe trasimin e rrugëve.

Spektori i Preventivës ndaj zjarrit dhe hulumtimit

Gjatë kësaj periudhe sektori i preventivës ndaj zjarrit ka qenë elementi thelbësor në gjetjen dhe hulumtimin e shkaktarëve të zjarreve në Komunen e Kamenicës, ku sipas planprogramit të punës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, duke i kryer të gjitha aktivitetet në fushën e mbrojtjes nga zjarri:

1. Inspektime të rregullta në objekte publike dhe private;
2. Dalje në vendin e ngjarjes për hulumtimin e shkaktarëve të shpërthimit të zjarreve;
3. Lëshimi i pëlqimeve për mbrojtje nga zjarri në dokumentacionin inventivo-teknik për ndërtimin e objekteve;
4. Gjatë kësaj periudhe janë kryer inspektime të rregullta në objektet të impianteve për shitjen e derivateve të naftës dhe gazit (Butanit), objektet industriale, lokaleve afariste, institucioneve shkollore dhe shëndetësore;
5. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me hetuesit e stacionit policor me të cilët kemi dalur në vendin e ngjarjes për hulumtimin e shkaqeve të shpërthimit të zjarrit;

Gjatë këtij gjashtëmujori janë kryer këto inspektime:

- 1. Në sektorin publik.....8**
- 2. Në sektorin privat.....18**

SFIDAT

Gjatë kësaj periudhe DMSH ka hasur edhe në sfida gjatë implementimit të planprogramit të punës për vitin 2023 dhe atë:

- Mungesa e KKMSH (Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim);
- Mungesa e Fondit Emergjent.

-Mungesa e stafit.

Njësiti për Zjarrëfikje dhe Shpëtim (NjPZSH)

Njësia Profesionale e Zjarrfikëjes dhe Shpëtimit - Kamenicë

Stacioni i Zjarrëfikjes, Rr. Tahir Sinani, Nr.55 Tel: 193, 0280 371 583, 0280 315 392

ZYRJA E KUJDESTARISË:

Dispeqeri në zyrën e kujdestarisë në Stacionin e NjPZSh-së në Kamenicë dhe nënstacionin në Muçivërc pranon dhe regjistron të gjitha thirrjet në Fletëpranimin e Rastit që ka pranuar në telefonin kujdestar 193, regjistron të gjitha daljet dhe kohën e kthimit, plotëson dhe mban evidencën e pranimin të lajmit dhe raportet e udhëheqësit të aksionit duke i regjistruar në librin e dispeqerit dhe në Ditarin Operativ.

Dispeqeri ka plotsuar **253 Formularë për lajmrimin e zjarrit**, dhe **34 Formularë për intervenime teknik**. Në zyrën e kujdestarisë procesohen të gjitha kërkesat për pushime vjetore, për furnizime etj.

Në mungesë të zyreve në Stacionin e Zjarrëfikjes kjo zyre shfrytëzohet për mbajtjen e ligjeratave, trajnimeve, mbledhjeve dhe është nën përkujdesjen e dispeqerit 24 orë.

Në Ditarin Operativ dhe raportin fillestar të udhëheqësit të aksionit për shuarjen e zjarrit dhe intervenimeve teknike janë të regjistruara **287** raste prej tyre janë:

1. **253 raste në shurje të zjarrit**
2. **25 raste në intervenime teknike**
3. **3 raste të shërbimeve**
4. **3 raste aksidente rrugore**

5. **3** raste në vërshime, dhe
6. **0** raste të alarmit të rrejtshëm

Në raportin fillestar të udhëheqësit të aksionit për shuarjen e zjarrit janë të regjistruar **253** raste prej tyre :

1. **4** raste – zjarr në objekte ndërtimoe
2. **0** raste – zjarr në objekte ekonomike
3. **1** raste – zjarr në pajisje elektrike
4. **245** raste – zjarr në sipërfaqe të hapura
5. **3** raste – zjarr në automjete motorike

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera korrik-dhjetor 2023														
2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Korrik	25	12	7	0	3	3	0			0			0	25

Gusht	40	35	5	0	0	0	0			0			0	40
Shtator	86	78	7	1	0	0	0			0			0	86
Tetor	123	120	3	0	0	0	0			0			0	123
Nëntor	9	6	2	1	0	0	0			0			0	9
Dhjetor	4	2	1	1	0	0	0			0			0	4
Gjithsejtë	287	253	25	3	3	3	0	0	0	0	0	0	0	287


Nga të dhënat e raporteve i paraqesim numrin e përgjithshëm të intervenimeve për 6 mujorin e dytë të vitit 2023

Klasifikimi i rasteve të zjarrit nga numri i përgjithshëm i intervenimeve korrik - dhjetor 2023

	Zjarrë në Objekte	Zjarrë në	Zjarrë në	Zjarrë në	Zjar rë në	
2023	ndërtimore	Objekte ekonomike	Pajisje elektrike	Sipërfaqe të hapura	Aut om.	Gjith .

	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Paisjet shpërndare	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera	Automjete	
Korrik																2	3	6	1	12
Gusht			1													13	15	6		35
Shtator															12	39	18	9		78
Tetor	2		1											1	16	60	33	6	1	120
Nëntor																4	2			6
Dhjetor																1			1	2
Gjithsejtë	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	28	119	71	27	3	253

Rastet e intervenimeve do ti paraqesim sipas muajve korrik-dhjetor për vitin 2022 dhe 2023.



PUNA NË STACION:

Puna në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes punohet në 4 (katër) ekiye, të gjitha ekipet kanë nga 7 (shtatë) zjarrfikës, prej tyre 5 zjarrfikës janë në Stacionin Qendra në Kamenicë dhe 2 zjarrfikës në nënstacionin në Fsh.Muçiverc, aktivitetet bnda Stacionit zhvillohen sipas planprogramit për mirmbajtjen dhe riparimin e paisjeve, automjeteve dhe ndërtesës.

Në Njësin e Zjarrfikjes nga vullneti i mire i zjarrfikësve dhe menaxhimi i mirë i mjeteve gjithnjë jemi furnizuar vetëm me material, kurse punën e kemi kryer vetë gjithashtu edhe me ndrrimin e pjesëve dhe defekteve në automjete, pompa dhe autocisterna si dhe gëlqërosjen e objektit dhe ngjyrosjen e automjeteve zjarrfikëse.

BASHKËPUNIMI:

Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit ka një bashkëpunim të mirë me Strukturat Komunale, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent, Drejtoritë Komunale, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, FSK-në, KFOR-in, Policinë e Kosovës, me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, Shërbimet emergjente ku edhe në shumë raste ku janë të involvuar dy e më shumë njësi në incident ka një bashpunim dhe kordinim i mirfilltë i punës e më së shumti me Policinë e Kosovës. Rol të veçantë në kordinimin dhe bashkëpunimin në sferën e punës, trajnimit dhe në ndihmesën e realizimit të projekteve dhe planeve për trajnime në Stacion dhe organizata tjera për masat preventive dhe gatishmërinë e reagimeve ka dhënë dhe jep Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport veprojnë këta sektorë: Sektori i Kulturës, Sektori i Sportit dhe Sektori i Rinisë. Poashtu në kuadër të DKRS veprojnë edhe këto institucione: Shtëpia e Kulturës “Isa Kastrati”, Biblioteka e Qytetit “Drita” me degët e saj, Arkivi Historik Komunal dhe Qendra Rinore.

Sektorët dhe institucionet që veprojnë në kuadër të DKRS, gjatë vitit 2023, kanë zhvilluar aktivitetet në bazë të plan-programit që kanë dorëzuar në fillim të vitit kalendarik. Më tepër janë përqendruar në organizimin e manifestimeve komunale që tashmë janë tradicionale, në shqyrtimin e kërkesave të drejtuara në këta sektorë, në përkrahjen e të rinjve, artin letrar, artin figurativ, artin dramatik etj.

Në vijim do të paraqiten në mënyrë kronologjike disa nga aktivitetet e realizuara dhe fotografi nga aktivitetet .

Në kuadër të Manifestimit Tradicional “ Flaka e Janarit” 2023, u organizuan aktivitete të shumta, disa nga të cilat u realizuan për herë të parë, si; Koncerti i Filharmonisë së Kosovës, shfaqja e Teatrit Kombëtar të Kosovës, etj Në muajin shkurt, në bashkëpunim me Ambasadën Japoneze është organizuar Java e Kulturës Japoneze. Përmes aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga të rinjtë e KVRL-së u promovua kultura dhe traditat e veçanta të popullit japonez.

Për nderë të Festës së Pavarësisë, u organizua një manifestim tejet madhështorë.

Edhe në kuadër të këtij manifestimi për herë të parë, para qytetarëve të Komunës së Kamenicës, me një shfaqje tejet interesante, u paraqit Baleti Kombëtar i Kosovës.

Në kuadër të manifestimit “Epopeja e UÇK –së” u organizuan disa aktivitete , si;

- Turneu i Street-ball- it, me ekipet: Komuna, Veteranët e UCK-së, Policia, Zjarrfikësit, Qytetarët
- Instalacion me fotografi dhe video në shesh, tema: “ Epopeja”
- Ora e parë mësimore kushtuar “Epopesë së UCK-së”
- Tryezë diskutimi “ Të rinjtë me veteranët”
- Nata e Zjarreve – te Varrezat e Dëshmorëve në Kamenicë.

Në kuadër të Manifestimit Tradicional “ Lulëkuqet e Prillit”, me 22 prill, u organizua Akademia Përkujtimore, kushtuar Heroit Kombëtar, Isa Kastrati, me ç ‘rast edhe u zbulua shtatorja e tij, në Sheshin “ Metush Krasniqi”.

Edhe në kuadër të Manifestimit “ Qershori i Lirisë”, që organizohet me rastin e Ditës së Çlirimit të Kamenicës, u organizua për herë të parë Festivali i Valles Dyshe. Ky Festival mbledhi qindra qytetarë, të cilët përcojnë me vëmendje madhështinë e shfaqur përmes veshjeve e vallëzimit karakteristik të trojeve shqiptare.

Manifestimi tradicional “ Ditët e Diasporës” i cili këtë vit u quajt “Sumer Fest”, ishte tejet madhështorë. Gjatë periudhës korrik – gusht , qytetarët përcojnë aktivitete të shumta kulturore e sportive. Disa nga aktivitetet e realizuara ishin risi për qytetarët, gjë që ndikoi dukshëm në rritjen e shikueshmërisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve. Agjenda e vendosur më poshtë, tregon volumin e aktiviteteve, ndërsa fotografitë tregojnë pamje madhështore nga aktivitetet.

Aktiviteti më atraktiv i këtij manifestimi ishte Moto-Crossi . Ky aktivitet planifikohet të jetë tradicional. Nga fotot e vendosura në vijim mund të shihet që vërtetë ky aktivitet ishte i veçantë dhe shumë atraktiv.

Ecja tradicionale "Për një Kamenicë të Gjelbër" ku morën pjesë numër i konsiderueshëm i qytetarëve, pjesa dërmuese nga të cilët ishin të rinjë. Kjo ecje përveç tjerash ishte edhe promovim i natyrës së bukur e atraktive që posedon komuna jonë.

Si rezultat i nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Komunës së Kamenicës dhe CHëB Kosova, që kishte për synim mbrojtjen, promovimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore në Kamenicë, u organizua kampi “Heritage Lab”, me 17 studentë të Fakultetit të Arkitekturës,.

Ky kamp, i mbajtur nga data 20 deri me 24 nëntor, për 5 ditë radhazi, është fokusuar në dokumentimin dhe hartimin e planit të konservimit të hambarit dhe skenarëve për destinimin dhe shfrytëzimin e tij. Poashtu janë identifikuar elementet karakteristike kulturore të Komunës së Kamenicës, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave nga trashëgimia kulturore, trashëgimia natyrore, aktivitete kulturore, të dhënat statistikore për popullsinë, biznesin, arsimin etj.

Në kuadër të manifestimit për Festën e Flamurit , me 28 Nëntor , u organizuan disa aktivitete.

Përveç organizimit të manifestimeve tradicionale kulturore e sportive , DKRS, ka subvencionuar organizata kulturore e rinore, klube sportive e individ , përmes thirrjeve publike:

- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për OJQ- të kulturore; (vlera e përgjithshme e thirrjes 35000 euro)
- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për klubet sportive; (vlera e përgjithshme e thirrjes 32000 euro)
- Shpallja e thirrjes publike për mbështetje financiare për projekte rinore (vlera e përgjithshme e thirrjes 7000 euro)

Avancimi i kulturës është bërë edhe me pjesëmarrjen në projekte e programe të ndryshme;

- Pjesëmarrja në programin Gov4Saa për krijimin e Guidës Online (Ekipi punues është ndërsektorial, por një pjesë e madhe e projektit ka të bëjë me promovimin e trashëgimisë kulturore);
- Inicimi i procedurave për Shenjëzimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore sipas Udhëzimit Administrativ nga MKRS-ja, ku sqarohen specifikat e tabelave orientuese për asetet e trashëgimisë kulturore, por edhe për institucione tjera si: muzetë, bibliotekat, teatrot, stadiumet etj.;
- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjilan;

- Intervenime në objekte të trashëgimisë kulturore:
 - Restaurimi i Xhamisë së Vryçecit (QRTK),
 - Restaurimi i kambanës në Manastirin ‘Qeli’ (Burg), Hajnoc (UNDP),
 - Restaurimi i kishës në Vaganesh (UNDP\CHëB);
- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Teatrin e Gjilanit
- Nënshkrimi i memorandumit me CHëB –në
- Vazhdimi i punimeve në Stadiumin e Kikës, në Hogosht;
- Inicimi i procedurave në MKRS për mbështetje financiare për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës, në Roganë-Novosellë;
- Koordinimi me Federatën e Atletikës për hartimin e projektit të Stadiumit të Atletikës
- Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MKRS për hartimin e draft koncept-dokumentit për strategjinë e sportit
- Pjesëmarrje në takimet e organizuara nga MKRS për draftin e konceptit për sportin shkollor;
- Takime me Komitetin Olimpik të Kosovës, Federata respektive të Kosovës dhe faktorë të rëndësishëm në fushën e kulturës dhe sportit;
- Aktivizimi i kinemasë, shfaqja e filmave shqip në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe shfaqja e filmave Premierë me Kinemanë ABC;
- Koordinim me Baletin Kombëtar për të shfaqur një pikë baleti në Teatrin e Qytetit;
- Koordinim me Filharmoninë e Kosovës, organizimi i koncertit të mbajtur në Komunën e Kamenicës, në muajin janar;
- Inicimi i formimit të Korit të Fëmijëve, në bashkëpunim me Shkollën e Muzikës;

- Ecja “Për një Kamenicë të gjelbër” (edicioni i dytë).
- Vizitë koleksionistit privat të trashëgimisë kulturore Shefki Thaqi nga fshati Muqivërc , i cili posedon rreth 700 arte fakte

Problemet e identifikuara brenda DKRS që përbëjnë vështirësi për realizimin e punëve

- Mungesa e një strategjie të përgjithshme zhvillimore për sektorët e kulturës, të rinisë dhe të sportit në Komunën e Kamenicës;
- Kapacitetet e pamjaftueshme profesionale dhe mungesa e shpërndarjes së informacionit mbi aktivitetet e realizuara;
- Niveli i pakënaqshëm i koordinimit me faktorët relevantë për zhvillimin e projekteve.

Punë\projekte të planifikuara që 2024

- Angazhimi rreth themelimit të Muzeut të qytetit dhe gjetja e fondeve për restaurimin e objektit ekzistues, ose ndërtimin e objektit të ri.
- Inicimi i procedurave për rregullimin e rrethojës te vendi i caktuar për piknik

“ Te pishat “.

- Inicimi i rregullimit të ujësjellësit dhe kanalizimit “ Te pishat “.
- Rregullimi i vendit për ndezjen e zjarrit te Varrezat e Dëshmorëve”.
- Rregullimi i Flakadanëve te Shtëpitë Muze “ Kadri Zeka” “ Nuhi Berisha” dhe Rexhap Mala”.
- Rregullimi i ujësjellësit te Shtëpia Muze “Kadri Zeka “ dhe angazhimi i një mirëmbajtësi të Shtëpive Muze.
- Përkrahja e koleksionistëve privat të trashëgimisë kulturore .
- Botimi i katalogut “Trashëgimia Kulturore e Komunës së Kamenicës”
Sipas Memorandumit të lidhur me QRTK-në, Komuna e Kamenicës obligohet të angazhojë një fotograf, një lektor, një

redaktor dhe një përkthyes. Fotografi i komunës është i angazhuar me fotografimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, ndërsa edhe lektorin, redaktorin dhe përkthyesin do t'i angazhojmë nga potencialet e brendshme të Komunës.

- Adaptimi i ambientit në Kalanë e Kulinës, Kamenicë
 - Rregullimi i ndriçimit, shtigjeve, tabelave informuese etj.;
 - Inicimi i procedurave për shpronësim të rrugës lidhëse me kalanë
Këtë projekt planifikojmë ta realizojmë në bashkëpunim me CHëB. Projektin për ndriçimin e kemi realizuar. Jemi duke punuar për planifikimin e shtigjeve dhe tabelave informuese. Ndërsa rruga lidhëse rezulton që është pronë e një qytetari. Në këtë rast do të mundohemi të vëmë kontakt me të për të biseduar rreth mundësisë së shpronësimit, ndërrimit me një pronë tjetër, apo edhe për blerjen e pronës.
- Ndërtimi i Stadiumit të Atletikës (me kritere evropiane), mbështetur nga MKRS;
- Fuqizimi i të rinjëve të Kamenicës, sipas udhëzimeve të Strategjisë për Rini e cila është duke u hartuar nga MKRS;
- Organizimi i Panairit të Librit në Komunën e Kamenicës;
- Restaurimi i Xhamisë së Meshinës, në bashkëpunim me QRTK-Gjilan;
- Zhvillimi i jetës teatrore dhe organizimi i festivalit të teatrove amatore;
- Organizimi i një tryeze shkencore lidhur me veçoritë etnokulturore të Komunës së Kamenicës;
- Inicimi i formimit të ansamblit të këngëve dhe valleve në kuadër të DKRS

(me kërkesë në Kuvendin Komunal);

- Inicimi i zgjidhjes së statusit të Qendrës Rinore , si Institucion Rinor Komunal
- Shpallja e thirrjes publike për subvencionimin e OJQ-ve për organizimin e Manifestimeve Tradicionale;

- Thirrja publike për mbështetje për Klubet Sportive;
- Thirrja publike për mbështetje për individë;